ExLibris

E PËRJAVSHME LETRARE & KULTURORE

Themelues BUJAR HUDHRI
Kryeredaktore VIOLETA MURATI

E PREMTE, 28 DHJETOR 2018. NUMËR 7. VITI I I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Ylljet Aliçka një shkrimtar që ndan historinë politike me letërsinë e tij, me plot ironi e përshkrime makthesh, ku anarkia liberale zhvlerëson personazhet – I përkthyer në frengjisht, italisht, norvegjisht... Aliçka bashkë me disa autorë të tjerë shqiptarë, me botimin jashtë kufinjve, po krijojnë një jehonë të re letrare

YLLJET ALIÇKA
SHKRIMTARI E SHTON DOZËN E MORALIZIMIT SA MË SHUMË DËSHTON ME VEPRËN E TIJ

(Fq. 2)

OPINION

ANARKIA SI LIRI SUPREME

SHENJA NGA BREZI I ARTË

Nga Vladimir Myrtezai

(fq. 10)

Fondacioni "Harpa" e vlerëson për romanin më të mirë të vitit

VIRION GRAÇI
KUJTESA E ROMANIT DHURON GJAK PËR LEXUESIT, S'LIDHET ME NARRATIVËN E MODËS SË FUNDIT

(Fq. 6)

IN MEMORIAM

GËZIM QËNDRO "KINOSTUDIOJA" FJALA E FUNDIT E NJË INTELEKTUALI...

(Fq. 12)



FEST 2018

Fituese e Festivalit në RTSH
Jonida Maliqi, në Eurosong 2019 me "Ktheju tokës"

(Fq. 11)

KRITIKË

"Mimozat" e Martin Camajt Lirikë në kohën pendesës

Nga Yzedin Hima

(Fq. 5)

BIBLIOTEKË

POETËT BASHKËKOHORË SHQIPTARË NË ANTOLOGJINË GREKE

(Fq. 8)

GJENDET NJË DORËSHKRIM I HUMBUR I NOBELISTIT NAGUIB MAHFOUZ

PËRMBLEDHJA ME TREGIME ISHTE E FSHEHUR NË NJË KUTI

Nga Marcia Lynx Qualey

(Fq. 14)

Ylljet Aliçka një shkrimtar që ndan historinë politike me letërsinë e tij, me plot ironi e përshkrime makthesh, ku anarkia liberale zhvlerëson personazhet – I përkthyer në frengjisht, italisht, norvegjisht… Aliçka bashkë me disa autorë të tjerë shqiptarë, me botimin jashtë kufinjve, po krijojnë një jehonë të re letrare – ashtu siç edhe përcaktojnë për këtë autor mediat franceze se, "Absurdi me të gjitha format e tij të çon tinëzisht drejt poshtërsisë njerëzore..."

YLLJET ALIÇKA

SHKRIMTARI E SHTON DOZËN E MORALIZIMIT SA MË SHUMË DËSHTON ME VEPRËN E TIJ

Intervistoi: Violeta Murati

Takimi ynë i fundit, në një faqe kulturore letrare, ishte intervista në rastin e ribotimit të librit tuaj në frëngjisht dhe anglisht, ***Rrëfenja për ndërkombëtarët*, nga *Tirana Times*…Pata përshtypjen që risjellja e librit kishte të rëndësishme ngjarjen që e ndoqi, që gati u shpall një "libër i mallkuar", por i "legjitimuar" nga vetë Brukseli, ku edhe u përkthye si një manual. A ndani mendimin se ende po kalojmë përvoja të ngjashme me ato të para 100 viteve në këto raporte, se është koha për këtë debat, për një qasje kritike çfarë shkon mirë apo keq?**

Për një vend pa shumë peshë në skenën ndërkombëtare është dhe do të jetë gjithnjë koha për debate në lidhje me raportin e Shqipërisë me të huajt, pra ballafaqimi me dilemat nëse interesi i ndërkombëtarëve për Shqipërinë ka qenë, është apo do të jetë emergjencë, partneritet, bashkëpunim apo, në ndonjë rast, edhe alibi. Realiteti shqiptar ka dëshmuar se është më i ndërlikuar dhe më i copëtuar se parimet e vetë organizmave ndërkombëtarë. Në mjaft raste parimet në bllok, apo rregullat universale të këtyre organizmave, mbeten të papërshtatura në situata specifike të realitetit të koklavitur, apo jo në pak raste të interpretuara mbi shije dhe ndjesi individuale të përfaqësuesve ndërkombëtarë. Kam përshtypjen se ndjeshmëria ndërkombëtare ndaj vendit tonë ka prirje standardizimi, për të përfunduar shpesh në një retorikë të konsumuar.

Sado që romani po bën gati 10 vjet që ka dalë, unë i mbetem përherë mendimit se ka mjaft nëpunës ndërkombëtarë, shpesh anonim në vendet e tyre, të cilët me të ardhur në Shqipëri, gjatë "rropatjes për të ndihmuar këtë vend apo për t'u treguar vendasve rrugën e përparimit" u merr kuptim të ri jeta, falë përkujdesjes dhe mikpritjes së "indigjenëve". Nga ana tjetër, puna e tyre në vendin tonë dhe jo vetëm,në planin ekonomik përkon me privilegje financiare, kurse në planin shpirtëror kjo prirje shkon në favor të mendësive narcistike të ndërkombëtarit, si dhe dëshmon (vetëdëshmon) për "kurajën dhe heroizmin për të punuar dhe rrezikuar kokën në këtë humbëtirë". Fatmirësisht, duket se ka kaluar tashmë ajo periudhë kur ne shqiptarët vuajmë nga klishetë e glorifikimit të gjithçkaje që vjen nga jashtë, si dhe e magjepsjes ndaj së huajës. Ndofta po vjen duke u zvogëluar edhe prirja e individit shqiptar post-izolacionist për atë fenomen që do e quaja "aleancat e flirtet fluide me të huajt."

Mbi këtë përgjigje, në diskutimin për librin, shkrimtari Besnik Mustafaj donte t'ju "shpëtonte" duke ju sugjeruar të mos viktimizoheni nga një histori personale, por me një synim më të lartë, duke e vlerësuar librin tuaj se zbulon një dukuri, fenomen tipik shqiptar, për të krijuar idhuj, e trashëguar nga diktatura? Pati një rezistencë të kundërt nga ju, një farë replike, pse?

Në të vërtetë, aty ishim mbledhur për "hatrin" tim. Nuk isha unë që thashë se ai libër dhe autori i tij ka pasur peripeci, por dikush që punonte në organizmat ndërkombëtarë. Në lidhje me ndërhyrjen e Besnikut, le të themi se kishte formatin e një kritike miqësore. Meqenëse e ringrini këtë pyetje, them se në të vërtetë ai libër nuk kaloi pa u vënë re si nga ndërkombëtarët ashtu dhe kombëtarët, me vlerësime pozitive dhe negative nga të dyja palët. Kur e shkrova, nuk u nisa për të bërë as heroin as antiheroin, thjesht nga një ngacmim personal, dhe nuk e mohoj që për një periudhë kam pasur probleme, madje ndonjë moment gati të viktimizohesha se, qoftë larg, po dëmtoja procesin integrues të vendit! Por, krahas telasheve, them se ai libër më solli edhe shumë lexues.

Nga një vështrim mbi biografinë tuaj, mbani gradën shkencore "Doktor i shkencave", kur më herët ishit në detyrën e mësuesit, mos gaboj rreth viteve '73-'83, më pas ka një shmangie nga "edukimi" dhe tani që flasim jeni pedagog duke i shtuar karrierës letrare edhe ca shkëndija kinematografike (të suksesshme). Çfarë shoh të ngjashme, është shqetësimi për të komunikuar mbi një gjë të "mangët", të "dobët", a mund të qartësoni më tej veten tuaj, shkrimtarin, në këto vendndodhje?

Sipas rrethanave, kam bërë disa "zanate" në jetë. Deri para ndërrimit të regjimit, ashtu si shumica e shqiptarëve, nuk e kam pasur luksin për të punuar aty ku do më pëlqente. Në lidhje me formimin universitar, s'më pyeti njeri kur më regjistruan te Shkencat e Natyrës për t'u bërë mësues. Nga ana tjetër, si një pjesë e madhe e shqiptarëve, nuk është se ajo kohë më ka ofruar shumë mundësi për të provuar veten në ato gjëra që doja. Fundja, si gjithë të tjerët.

Punën e mësuesit e kam bërë pa pasion, veçse kur rrallë doja ta bëja mirë atë punë, them se dija ta bëja. Ndofta nga ky shkak, nga fundi i viteve '80, u bëra dhe "Kandidat i shkencave" (ekuivalent i "Doktor i shkencave") dhe më vonë Profesor. Në këtë kuadër kam botuar mjaft libra në fushën e teksteve shkollore. Është kjo përvojë që më ka ndihur në ulje-ngritjet e jetës sime dhe që aktualisht kam një pozicion komod pune: pedagog pranë Universitetit Europian të Tiranës. Për një periudhë kohe kam punuar edhe si ambasador, punë që nuk mendoj se u dallova për ndonjë dështim a sukses të madh, thjesht u përpoqa ta bëj mirë. Pra, përgjithësisht, nuk jam i pakënaqur me ato gjëra që kam bërë në jetë. Kjo përvojë e gjatë dhe leximet më kanë bërë që ta "zbuloj" veten time si shkrimtar a skenarist filmi. Veçse, si kushdo, gjatë gjithë kësaj karriere rrallë jam bërë edhe target kritikash a dështimesh, kryesisht në ato "zanate" (diplomatit a shkrimtarit) që rëndom provokojnë, në rastin më të mirë, kureshtje...

Si e njihni dhe si ju frymëzon individi shqiptar në realitetin e djeshëm, apo atë të sotëm?

Paraprakisht, them se në raport me njohjen e tjetrit ende jemi larg njohjes së vetes. Më shumë se njohja e vetvetes, më shumë në letërsi, më ka intriguar gënjimi i vetvetes. Pa dashur të rendis këtu vlerat që na dallojnë ne si shqiptarë, si shumëkombe të tjera, ne priremi t'i interpretojmë apo argumentojmë gjërat nga këndvështrimi i narcizmit tonë, duke përligjur si të mirë gjithçka që lidhet direkt apo indirekt me interesat vetjake, sidomos me ato që kanë të bëjnë me protagonizmin, me nxjerrjen në pah të zgjuarsisë, njeriut të mirë, përfitimit material, apo trimërisë dhe nga ana tjetër, t'i gjykojmë si shoqërisht të padrejtë, madje të

bindim edhe veten se çdo gjë që cenon ndonjë nga parametrat e sipërpërmendur, është e keqe dhe jashtë normave të pranuara. Njihet fakti se njeriu i shton dozat e moralizimeve për veten sa më shumë dështon në jetën e tij. E më pas, duke ia fshehur edhe vetes xhelozitë apo mllefet që e motivojnë, i bën apel moralit të mirë për të stigmatizuar tjetrin. Kjo më kujton thënien e Sartrit "Ferri janë të tjerët". Pra, ashtu siç kemi prirjen për të menduar apo folur keq për të tjerët, d.m.th. ferri janë tjerët, ashtu flasin edhe të tjerët për ty, pra aq sa tjetri është ferr në mendjen apo bisedat e tua, aq je edhe ti ferr në mendjen apo bisedat e tjetrit. Në këtë mes secili ka prirjen t'i japë të drejtë vetes, vetëkuptohet duke i veshur blasfemitë e tij me parimet e moralit të shëndoshë, pra në emër të së mirës së përgjithshme! Bie fjala, njeriu ka mundësi ta njohë veten se sa i ndershëm apo sa i korruptuar është vetëm kur ballafaqohet me një ofertë të mirë korrupsioni fitimprurës, atëherë ti provon se sa je në gjendje t'i rezistosh apo jo një tentacioni të tillë, e të mos biesh pré e moralizimeve fiktive.

Apo atëherë kur, mos qoftë, rastis që në rutinën e jetës tënde të përditshme të të trazojë shpirtin "misteri i ëmbël i personalitetit" të një gruaje dhe ti i turbulluar nuk di nga t'ia mbash: nga ruajtja e moralit apo nga joshja ndaj mëkatit.

Për të mos folur kur, le të themi, dikushi vardiset pas "gruas me mister të ëmbël" dhe ajo, mos o Zot, s'të pranon e të kthen kurrizin. Atëherë ndodh që ti mezi pret të shpalosësh "moralin tënd të pastër" e t'i vërsulesh kujtdo që ka fatin e keq që t'i zbulohet mëkati i dashurisë, për ta linçuar atë në sallë parlamenti, në emisione televizive, në klube, apo rrjete sociale, shkurt për ta bërë objekt sulmesh publike, nën etiketimet e shoqërisë me moral të mirë. Mendoj se kjo logjikë (sado e thjeshtë në dukje) funksionon edhe në preferencat apo antipatitë politike, ku, pa dashur ta përgjithësoj, mendoj se shpesh njeriu ia fsheh vetes se përse krijon simpati apo tifozllëk për një forcë politike apo antipati për tjetrën, duke u përpjekur t'i veshë, përligjë, apo interpretojë këto preferenca me argumente objektive e të pranueshme për opinionin dhe për veten, si papunësia, varfëria, padrejtësia, morali, pra ku çdo kriter i interesit të ngushtë qoftë material, qoftë promovimit të protagonizmit personal, priret të argumentohet me shkaqet e mësipërme objektive.

Duhet të jetë ky niveli i maturimit të një shoqërie apo individit, pra raporti midis faktorëve objektivë të formulimit të një bindjeje politike me ata që lidhen me interesat apo egon e ngushtë të individit, që në një pjesë të mirë përcaktojnë dhe momentet historike politike, si hedhja e votës apo pjesëmarrja në një aksion politik masiv.

Si vijnë historitë e romaneve tuaja, i shohim pothuaj në një linjë, histori politike për shpresën e humbur?
Përgjigjen po e marr nga një koment i shkurtër që shkroi gazeta "Le monde", pas botimit të *Parullave me gurë* në frëngjisht: *"Si përgjatë makthit të partisë unike, ashtu dhe nën anarkinë liberale që e zëvendësoi atë, e njëjta shpërbërje morale që i zhvlerëson personazhet e Aliçkës. Absurdi me të gjitha format e tij që të çon tinëzisht drejt poshtërsisë. Trembëdhjetë tregime nga ku kupton se ideologjia s'është veçse një guaskë boshe."* Në një plan më të gjerë, në letërsi më ka intriguar raporti mes pritshmërive dhe realitetit, shpresës dhe zhgënjimit, raport ky që përcakton gjendjen e lumtur apo të trishtuar të njeriut. Nga ana tjetër, më shumë se e kushtëzuar nga mungesa apo tkurrjet e dëshirave në përgjithësi, lumturia apo trishtimi përcaktohet nga dallimet mes qenieve njerëzore në rrethana të caktuara kohe e vendi. Bie fjala, një i ri i brezit tim, pra i asaj kohe, kishte arsye të ndihej më i lumtur se të tjerët po të kishte një manjeton, vishte rroba të jashtme, ndërkohë që tjetri s'i kishte këto, nuk ishte...Kam përshtypjen se këto detaje, gati të parëndësishme në dukje, e lumturonin në mënyrë të pandërgjegjshme të riun me biografi të mirë dhe që ndofta sot e bëjnë të ndiejë nostalgji për atë kohë. Pra, me ndryshimin e kohërave, sistemeve politike, ndryshojnë edhe ndjesitë apo perceptimet e lumturisë dhe zhgënjimit. Nëse atë kohë një vajzë lumturohej po t'i dhuroje një sapun *Camai*, sot ky lloj sapuni është zhvleftësuar si objekt lumturie, për t'u zëvendësuar, bie fjala, me një makinë luksoze apo një gjerdan *Swarovski*.

Dhe diçka që m'u kujtua tek po shkruaja këtë intervistë: të gjithëve na bën përshtypje fakti që bashkëpatriotët tanë në emigracion apo për arsye të tjera larg vendit, vazhdojnë ta perceptojnë apo të ruajnë të njëjtat referenca me vendin, pra të kenë të njëjtat pritshmëri me ato që kanë pasur aq vite sa janë larguar, duke harruar pandërgjegjshëm dinamikën, evolucionin ekonomik, politik, social, kulturor e sidomos shpirtëror, pra se, si kudo në botë, edhe në vendin tënd koha nuk ka ndalur. Për pasojë, gjithmonë në mënyrë të pandërgjegjshme, një sindromë e tillë bëhet burim keqperceptimesh, keqkuptimi dhe orientimi të gabuar ndaj realitetit të vendit tënd.

Ju zbuloni nga tregimet tuaja një realitet ku botët vijnë të rrëfyera thellësisht me gjithë anët tinëzare dhe poshtërsitë e ditëve tona. Nuk e di nëse keni parasysh njeriun apo shqiptarët me rrethanën e tyre?
Sipas meje, Shqipëria dhe shqiptarët kanë ndjekur dhe po ndjekin rrugën e natyrshme që ndjek evolucioni i një shoqërie postdiktatoriale, me vlerat dhe antivlerat e saj, shpesh e prirur ndjeshëm ndaj indoktrinimit, me modele të imponuara sjelljeje, mendimi dhe përfaqësimi, me individë me sistem njohës të manipuluar apo, siç thotë Adam Michnik, *"gjykatës të varfër të interesave vetjake,qëmë shumë kontribuojnë për rritjen e individualizmit irracional"*. Është fakt se mjedisi i sotëm social është mbushur me propagandë politike që përqendrohet te pabarazia e pasurisë dhe e fuqisë. Është e tepërt të kujtojmë se një fenomen i tillë çon në "fabrikimin e një ndërgjegjeje të gënjeshtërt". Sot jemi dëshmitarë të një stili individualist të të jetuarit, apo nga një stil i ri klasor, tashmë jo mbi baza biografie, por mbi baza pasurie.

Kur e keni nisur shkrimin e letërsisë? Temat tuaja na duken reminishenca për të cilat njerëzit, lexuesi, ka ende probleme me përballjen…
Unë kam filluar të shkruaj vonë, nga mesi i viteve nëntëdhjetë. Kjo jo domosdoshmërisht ngaqë prisja demokracinë që të shkruaja, por thjesht ashtu erdhi... nga rrethanat.

Kam nisur me përkthime poezish autorësh a kantautorësh dekadentë (Brassans, Cohen, De Andre...). Përktheja për kënaqësi, pa pasur ndonjë objektiv për t'u bërë shkrimtar a përkthyes.

Artistikisht, ndër tregimet më të spikatura janë, pa dyshim, *Parullat me gurë* që u shndërruan në shembull jo vetëm për lexuesit, por edhe për spektatorët, ndër prodhimet kinematografike me të sukseshme. Mendoj të aktualizoj një pyetje: deri në ç'masë individi shqiptar është përgjegjës për poshtërimin e vet?
Për mua, përballja me periferinë e jetës rutinë është esenca për t'iu afruar më shumë të kuptuarit të egërsisë së diktaturës shqiptare, sofistikimit të saj, mënyrat e zotërimit të mendimeve e ndjenjave të individit. Nga ana artistike, ajo periudhë për mua ishte një laborator i natyrës njerëzore, na tregoi se deri ku shkon nënshtrimi, kuraja, frika dhe dhunimi i njeriut. Asaj periudhe i përket krejt vëllimi *Parullat me gurë*. Unë nuk kam ndonjë objeksion të madh me komunizmin në vetvete, por me instrumentalizimin e tij si një platformë vetëjustifikimii qenies njerëzore për të vënë në jetë instinktet e tij shtazarake, të dhunimit të dinjitetit të njeriut apo mbizotërimi të jetës së tjetrit. Bie fjala,

ç'kishte komuniste kënaqësia që ndiente sekretari i partisë së kooperativës kur propozonte masën e internimit ndaj një mësuesi fshati pse ai nuk e mbante mirë drejtimin e shkrimit të një parulle politike në mur apo në kodër... Them se përveç kënaqësisë sadiste karshi vuajtjes së tjetrit, nuk kishte motivacion tjetër. Për inerci, këto reminishenca i hasim rëndom edhe sot. Shikojmë se aty-këtu po ringjallet kultura e dyshimit, e cila jo vetëm nuhat viktimën e radhës, por që, nga ana tjetër, mbjell paaftësinë e gjykimit real të rrethanave dhe dorëheqje nga kuptimi i gjërave. Për pasojë, individëve të sotëm u duhet të përshtaten, apo ballafaqohen, edhe me pamundësinë e mjaft strukturave apo individëve me pushtet, të cilat paralelisht me përpjekjet për të forcuar shtetin e së drejtës dhe respektin ndaj institucioneve, nuk ia dalin dot t'u vënë fre impulseve të tyre agresive. Në një mënyrë apo tjetrën, është vetë shoqëria e sotme shqiptare që po ofron elemente të mjaftueshme për atë që quhet "ndërgjegjësim fals të grupeve të gjera të popullsisë", ku informimi publik është shndërruar në komunikim interesash, apo ku narcizmi etno-kulturor shitet si vatër e vlerave të së ardhmes, mjedise këto të përshtatshme për të fikur në mendjen e njeriut çdolloj dyshimi të natyrës njohëse, për të kontrolluar mendimet, si dhe për të rritur pandjeshmërinë ndaj mendimit alternativ.

Cilat momente të jetës suaj kanë ndikuar më tepër në krijimtari?

Jeta e përditshme ku më së shumti nuk i vëmë gjithmonë re gjërat siç janë, por për të ardhur te pyetja juaj, mendoj se më shumë gjurmë më ka lënë ajo pjesë e jetës sime 10-vjeçare si "intelektual fshati", me një ndjenjë të theksuar vetmie, ajo kohë kur provova bixhozin me shijen përkatëse të humbjes, "bujtjet për mik" nëpër shtëpitë e fshatarëve, kur përpiqeshim të "koincidonim" të mbushnim ujë te burimi atëherë kur shkonin edhe vajzat e fshatit...Shtoj se shumë ndikime i kam nga përjetimet e fëmijërisë.

Gazeta *ExLibris* e mbyll vitin me këtë intervistë që, *në fakt*, na ndërmend festimet e Vitit të Ri, duke u zëvendësuar Krishtlindjet. Tërthorazi, kujtoj komunizmin, kur për herë të parë u përballët me letërsinë e ndaluar, cilët ishin librat e parë që ju ranë në duar?

Falë pro hibicionizmit, pra si çdo gjë e ndaluar, sa herë qëmë binte në dorë ndonjë libër i ndaluar, ngazëllehesha dhe e lexoja me të tillë interes dhe shije leximi që, fatkeqësisht, më ka humbur...

Në lidhje me librat, më kujtohet që kam ndjekur për vite me radhë një revistë tremujore italiane, *L'Europaletteraria*, një thesar i vërtetë i letërsisë botërore, ndërsa si libra më vijnë ndër mend *Imoralisti* i Andre Gide, *Neveria* e Zhan Pol Sartrit, *I huaji* i Albert Kamysë, *Shënime nga shtëpia e vdekur* e Dostojevskit...

Ju keni një tregim që ironizon fenë, madje, me sa kujtoj, u realizua edhe film dhe ndezi një debat. Këtë mund ta lexojmë si panatyrshmëri se si feja po depërton sot në shoqërinë shqiptare, edhe pse kemi humbje të besimit për 45 vite nga diktatura?

Jo, nuk e ironizoj fenë, por instrumentalizimin apo adoptimin fals të besimeve fetare. Mendoj se rilindja shpirtërore e shqiptarëve nuk përkoi plotësisht me nevojën e brendshme instiktive të individit apo komunitetit për të rigjetur natyrshëm ushqimin e duhur shpirtëror, atë ushqim që do ta ekuilibronte në realitetet e reja, por në një pjesë të madhe u karakterizua nga një konfuzion dhe humbje busulle. Rigjetja e këtij ekuilibri po kërkon kohën e saj, madje vazhdon edhe sot në dinamikën e saj. Duam apo s'duam ta pranojmë, pas rënies së komunizmit, krahas nevojave shpirtërore, individi shqiptar u përfshi nën ato ombrella vlerash aty ku ndien se fiton ekonomikisht, se aty mbrohet nga një rrezik, apo se aty merr vlerë protagonizmii tij.

Kam mendimin se po i njëjti kriter mund të ketë funksionuar historikisht dhe me shumë shqiptarë në Kosovë e Maqedoni, të cilët të kërcënuar nga asimilimi i tyre kombëtar nga një komunitet me një identitet të caktuar fetar, kanë gjetur mbrojtje te një vlerë alternative shpirtërore.

"Një komedi alla italiane nga Shqipëria", - kështu shkruan revista e njohur italiane "Internazionale.it" mbi romanin *Një ëndërr italiane*, është një analizë që i bën këtij romani kritiku i njohur italian Goffredo Fofi duke u ndalur në stilin ironik (alla shqiptar dhe njëkohësisht alla italian).Ç'është kjo "ëndërr italiane" për ju?

Në këtë roman u përpoqa të interpretoj me mënyrën time një ngjarje që e kemi të njohur të gjithë.

Më ngacmoi një shkrim në gazetën "Corriere della sera", mbi fatin e gjashtë personazheve që kryen një akt të guximshëm, gati donkishotesk, në kërkim të lumturisë, apo më mirë njëfarë mirazhi të lumturisë. Ajo që më tërhoqi më shumë në jetën e tyre, ishte tretja apo shpërbërja e shpresës për një jetë më të mirë apo për të kapur lumturinë, zhgënjimi i tyre i thellë, shkërmoqja e ëndrrës, bie fjala, për të bërë një martesë alla italiane, në një kishë pranë detit blu nën tingujt e ndonjë valsi lumturie...



Nga viti 2013 kemi folur sërish së bashku mbi mendimin përse të huajt nuk e përkthejnë letërsinë shqipe, ja ku jemi në të njëjtin agor për ta ngacmuar këtë temë, por tani në një perspektivë më optimiste. Ju jeni botuar si libër më vete, nëse s'gabohem, në gati 7 gjuhë të huaja. Çfarë reference është të jesh i botuar nga një ent prestigjioz brenda vendit tënd dhe sa konsiderohet kjo kur kalon kufijtë?

Po e nis nga vetja. Për mua nuk ka qenë dhe nuk është fare e lehtë për t'u botuar jashtë vendit. Madje, e shoh se kjo gjë po bëhet gjithnjë e më vështirë. Në lidhje me vështirësitë e botimit të letërsisë shqipe jashtë vendit, arsyet janë komplekse. Botuesit e huaj, me të cilët ne përplasemi për t'u botuar, i përpunojnë vlerësimet e tyre mbi realitetin shqiptar shumë më ngadalë se lexuesi apo botuesi shqiptar, dhe siç dëshmon përvoja, shpesh me prirjen për t'i parë ato nën këndvështrime sensacionale, apo ekzotike, që shpesh janë bërë burime opinionesh të deformuara mbi vendin tonë. Ka një dallim shpesh të ndjeshëm ndërmjet vlerësimit, do të thosha real ose më afër realitetit që kemi ne për vendin tonë, dhe perceptimit që kanë të huajt për ne. Kjo gjë e vështirëson bërjen e një vlerësimi real për një vepër letrare shqiptare, pra të orientohesh se ku fillon fantazia e shkrimtarit apo realiteti, apo ku mbizotëron prirja për t'iu përshtatur perceptimit të mësipërm ekzotik të lexuesit të huaj. Në lidhje me hierarkitë letrare të shtëpive botuese, prestigjioze apo jo, personalisht, me ndonjë përjashtim (në Norvegji jam botuar nga një botues të madh...), pavarësisht përpjekjeve, nuk kam mundur "të kap" ndonjë botues të rëndësishëm, bie fjala, si Gallimard, Mondadorietj. Në një plan më të gjerë e konsideroj arritje botimin e letërsisë shqipe dhe me botues të vegjël. Më shumë se sa niveli i botuesit, merr vlerë jehona që i bën librit media e huaj. Paradoksi ndodh me jehonën a pasqyrimin e botimeve jashtë vendit në shtypin a opinion tonë të brendshëm, që do ta quaja një lloj standardizimi a abuzimi mediatik, duke barasvlerësuar si botimin në një shtëpi botuese serioze, me ndonjë botim bërë me paratë e vetë autorit, apo botues gati me profil shtypshkronje.

Sa e rëndësishme është për ju njohja e veprës në Europë? Ka njerëz të letrave që ende nuk i kanë lexuar librat tuaj?

Natyrisht që e vlerësoj shumë botimin e librave të mi në gjuhë të tjera dhe kështu duhet të jetë për çdo shkrimtar, pavarësisht nëse pohohet hapur apo jo. Kjo s'do të thotë që nuk e vlerësoj vlerësimin nga lexuesi shqiptar. Madje, unë ndihem i përkëdhelur në vend, mjaft të kujtoj që pothuaj çdo libër i imi nuk ka kaluar pa marrë ndonjë çmim në nivel kombëtar.

A besoni vërtet se letërsia mbetet mediumi i vetëm krijues që përfaqëson zërat e shkrimtarëve? I referohem me këtë një takimi ku ju keni marrë pjesë në kuadër të projektit "10 shkrimtarë bashkëkohorë prezantuan arritjet e letërsisë së sotme europiane". Por, në fakt, në kontekst më politik, motoja artikulohej si njohje më e mirë e Europës përmes letërsisë.

Nuk më duket se ka ndonjë paradoks në pjesën e parë të pyetjes suaj, sepse e kundërta do ishte që letërsia do duhej të përfaqësohej jo nga shkrimtarët, por, bie fjala, nga bukëpjekësit, a hekurkthyesit...Në lidhje me përfshirjen në projektin që ju i referoheni, "10 shkrimtarë të letërsisë europiane", bëhet fjalë për një ndër programet e shumta europiane, ku lexohen pjesë nga 10 shkrimtarë europianë bashkëkohorë, nëpër qytetet e Europës, mes të cilëve ishte edhe një libër i imi me tregime. Padyshim që ishte një hapësirë e mirëpromovuese dhe natyrisht që të sillte edhe kënaqësi të nivelit praktik.

U jemi drejtuar edhe shkrimtarëve të tjerë me pyetjen pse nuk gjen prehje një shkrimtar kur shohim botimet e tyre si kanë lëvizur nga një shtëpi botuese në tjetrën. E njëjta pyetje edhe për ju, kur shohim hartën: Onufri, 1998; Albimazh, 2003; OSMCA, 2006; Toena, 2009 e 2012; Tirana Times…

Kryesisht për shkak të interesit financiar, apo dhe kujdesit të botuesit për t'u promovuar. Shpesh kur ndërrojmë shtëpi botuese, këto arsye kamuflohen nga ne shkrimtarët.

Diplomat, ambasador, keni punuar në institucione ndërkombëtare brenda vendit dhe tani jeni instaluar në rolin e pedagogut. Si ju duket tani jeta, a do kemi ndonjë roman reflektues për punën që bëni…Me "ndërkombëtarët" goditi ironia? Çfarë po shkruani tani?

Pesë vjet pas botimit të *Valsi i lumturisë*, jam në prag të botimit të një romani të ri. Romani ka për objekt dritëhijet e qytetit ku kam lindur dhe jetoj, Tiranës, nën diktaturë dhe postdiktaturë: evolucioni i vlerave dhe antivlerave i qytetarëve të saj, në planin social, ekonomik e sidomos politik... Tirana, si laborator i natyrës njerëzore. Pak a shumë i shkruar me të njëjtin stil si *Ndërkombëtarët*. E pres me interes këtë botim, sepse shkruaj rrallë, ky është libri i pestë i krejt "aventurës sime letrare" dhe sipas meje, më i miri.

"MIMOZAT" E MARTIN ÇAMAJT LIRIKË NË KOHËN PENDESËS

Nga Yzedin Hima



"Ai, madje, i shikon me "përçmim" duart e tij, duart tona "të vrashta", të cilat janë shndërruar në të tilla për shkak se nuk kanë "përkitur" (prekur) gratë mimoza, a mimozat gra, dhe duke humbur funksionin fisnik, janë shndërruar në duar të gurta, duar pa ndijesi, në vegla, llamarina, kova a lopata". Poezia *Mimozat* e poetit Martin Camaj është nyjëtuar si një tekst hermetik, ku midis vargjeve dallohen sytha simbolesh si shenja ftuese, si grishje për t'u afruar në honet e mungesës së fjalës e aty, kapur pas fjalës së munguar, si pas fillit të Arianës, të përshkosh labirintin e mundimshëm të formës, ku derdhet terri, e pastaj drejt e në dritën e kuptimit, ku forma tretet në domethënie si terri i honit shkimet në dritë. Si çdo lexim i një teksti të arrirë, leximi i poezive të Martin Camajt është një aventurë plot të papritura, ku në analizë të fundit kërkohet, zbulohet, krijohet dhe përjetohet *e bukura.*

Simjet për të parën herë
Mimozat në dorën e një vashe i pashë
Qetësisht tue marrun frymë si në degë.

Janë tri vargjet e para të kësaj poezie. Po pse pikërisht "simjet" dhe jo vjet apo parvjet, apo kaherë?! Fjala që mungon është pikërisht koha ekzakte: simjet: në janar, në shkurt, në mars, në prill apo në dhjetor?!

Mimozat çelin herët në shkurt dhe janë paralajmëruese të stinëve të bukura vijuese. Me ç'duket, ky shpërthim mimozash në pastinë na çon drejt kuptimeve të tjera: nuk ka çelur mimoza, por ka shpërthyer vajza në lule, bukuri, aromë e dashni. Duke paralajmëruar stinët e lulëzimit të saj dhe njëheri dimrin e stinës së unit poetik:

Mimozat erdhën tue pru me vehte
Ngjyrën e ditëve të blera,
Afshin e zemrave që rriten nga një fije
Për ditë, pëshpëritjet e egra e të lehta
Të atyne që shkelën në prakun e jetës
Me kambë të dyshimta, me frigë.

Mjedisi i vizatuar është ekzotik. Në këtë mjedis ka kaluar çdo njeri, por sa ka ditur ai të qëndrojë, të vëzhgojë, të kërkojë, të gjejë, të zbulojë, të përjetojë gjithçka që të ofron ajo kohë dhe hapësirë? E ka kaluar këtë mjedis si Odiseu "i lidhur" pas shtyllave të moralit, si Diogjeni me qiri në dritë të diellit në kërkim të dashurisë, apo symbyllur e " duart e zëna me sende", siç shkruan më poshtë Camaj?!

Dhe këtu shfaqet pendesa.

Uni poetik ndihet i penduar thellë për vete dhe për të tjerë, sepse përdor shumësin në vend të njëjësit. Ai madje i shikon me "përçmim" duart e tij, duart tona "të vrashta", të cilat janë shndërruar në të tilla për shkak se nuk kanë "përkitur" (prekur) gratë mimoza, a mimozat gra, dhe duke humbur funksionin fisnik, janë shndërruar në duar të gurta, duar pa ndijesi. Nëse ato do të preknin, përkëdhelnin, do të ishin duar të buta, të ndijshme, njerëzore. Kanë humbur funksionin e tyre më të fisëm, duke e zëvendësuar atë me mbartjen e sendeve, duke u kthyer në vegla pa shpirt, si llamarina, lopata apo kova. Dhe mendimi zgjatet më tej se edhe njeriu bashkë me duart do ketë humbur edhe pjesë të tjera të tij, ndoshta edhe shpirtin e tij dhe është shndërruar në rob të sendeve:

Me duart tona të vrashta,
të zanuna me sende të tjera,
s'kemi si me i përkitë

Uni poetik e shikon efektin vrastar "të mospërkitjes", jo thjesht te vetja, tek të tjerët, por shumë më të dhimbshëm, shumë më të kobshëm te gruaja. Ai ndihet fajtor për të gjithë burrat e botës, ku shikon se mimozat femra, për këtë shkak, e humbin aromën dhe shndërrohen në gra vjeshtore. Kjo mungesë është aq e madhe për gruan sa e shndërron atë nga një grua në moshën më të bukur, në një grua të moshuar, grua vjeshtore, siç e quan Camaj:

dhe aroma u humb n'erna lulesh
të mbytuna në parzmet e grave vjeshtore.

Pastaj vjen koha e pendesës, plot trishtim, pamundësi. Nëpërmjet një klithme a apostrofe uni poetik kërkon të pamundurën:

O ti mimozë e re, bartse kujtimesh,
mes stinëve dhe e pa stinë,
çka të baj me kthye te ti dhe 'i herë?

Natyrisht, uni poetik i ka flakur sendet, ose i ka parë se sa të pavlera janë dhe ndihet thellësisht i penduar për duart e zëna, ndihet i liruar nga robëria e sendeve, ndaj i drejtohet jo mimozës që çel në stinën e saj, por mimozës që çel mes stinëve dhe pa stinë, duke qenë i gatshëm të bëjë të pamundurën për kthimin e kohës që shkon e nuk kthen.

Berat, 2018

Me vlerësimin "Shkrimtar me vlera të larta krijuese. Autor me individualitet krijues që ka krijuar kode unike ligjërimi, duke pasuruar prozën romanore shqipe", Virion Graçit iu dha në Fier Çmimi Letrar Kombëtar nga fondacioni "Harpa", për romanin "Pëllumbat i vrasin natën". Në bisedën e mëposhtme shkrimtari shpreh se mbi çfarë realitetesh ngrihen juritë dhe çmimet letrare sot, si dhe tërheq vëmendjen mbi librat e kujtesës, çfarë e ndan një tekst letrar në raport me narrativën e sotme.

VIRION GRAÇI

KUJTESA E ROMANIT DHURON GJAK PËR LEXUESIT, S'LIDHET ME NARRATIVËN E MODËS SË FUNDIT

Virion, ju jeni një njeri aktiv në fushën e letrave dhe pretendues me letërsinë që shkruani. A mund të kemi nga ju një pamje, një mendim mbi çfarë po ndodh në skenën letrare të këtyre dy viteve të fundit ku ndahen shumë çmime letrare… sa vlerë marrin për ju krijuesit dhe sa kanë ndikuar në lexueshmëri?

Me sa jam unë në dijeni, jepen disa çmime letrare, disa janë për libra e disa, më të shumtit e më kakofonuesit, jepen në festivale poezie a proze të shkurtër për të nderuar një tufë poezish a një tregim. Duket sikur veprimtarive iu vihet pika mbi "i" kur e shpallin një fitues, e mbase nuk e kanë keq; e keqja fillon kur shumëzohet e ekzagjerohet mediatikisht formati i veprimtarisë konkurruese dhe pesha e çmimit në fjalë: thua se u fitua një Nobel apo një çmim bibliotekash në Europë a në SHBA. Në fatin e librave të mi të lexuar, të çmuar e të njohur nga publiku, nuk kanë luajtur rol çmimet letrare (që nuk kam marrë për 25 vjet rresht) as (dy) çmimet e marra në tre-katër vitet e fundit: në kënaqësinë time njerëzore apo trishtimet e mia intelektuale po, kanë ndikuar shpalljet e ndryshme të jurive, sepse jam njeri i profesionit, jam studiues shkencor-letrar, d.m.th një lloj kujdestari e ligjëruesi publik për vlerat e faktet letrare, për hierarkinë e tyre, për vlerat e nënçmuara nga juritë e katedrat shkollore-universitare apo për pseudo-vlerat e mbivlerësuara po nga juritë e nga katedrat. Për mendimin tim, rrallëherë juritë kanë dashur të jenë të drejta, të ndershme, objektive e me standarde të larta estetike-letrare.

Raporti i jetës letrare në kryeqytet me atë çfarë ndodh nëpër qytete të tjera, vazhdon të ketë humnera ndarjeje, ndërsa një fondacion kulturor në Fier vlerëson shkrimtarët me çmime… ku, së fundi, jeni nderuar edhe ju, për romanin "Pëllumbat i vrasin natën". Ç'janë këto realitete, standarde?

Ky fondacion (Harpa) ka lindur në Fier me ideimin dhe mbështetjen e faktorëve shoqërorë-ekonomikë vendas, por gjeografia e emrave të përfshirë drejtpërsëdrejti në veprimtaritë e shumta të tyre nuk është aspak lokale-provinciale, por mbarëkombëtare në kuptimin më serioz të fjalës. Lista e profesorëve, kritikëve letrarë, lista e shkrimtarëve të shquar dhe e akademikëve që kanë qenë e janë pjesëmarrës aktivë e protagonistë në çdo veprimtari të "Harpës" si anëtarë jurish, si kumtues, si ligjërues është ndjeshëm më e madhe se në çdo veprimtari kulturore tiranase a ngjarje kulturore që kryhet në të ashtuquajturat qendra të mëdha urbane te ne. E kundërta mund të pikaset lehtë: institucione qendrore të shtetit këtu në Tiranë thërrasin rëndom në juri njerëz të rëndomtë, që nuk kanë asnjë status tjetër autorial në letërsi e në kritikë letrare veçse vetëshpalljes kritikë-kandar vlerash, shpërndarës sheqeri me pagesë nëpër faqet e fundit të gazetave. Për vlerësimin tim nga fondacioni "Harpa" nuk habitem aspak: kanë bërë një bilanc të punës sime gati 30-vjeçare në letërsi, si autor librash, kanë bërë atë bilanc që të tjerë individë, institucione e organizma nuk kanë pasur dëshirë ta bëjnë, nuk kanë pasur ndershmërinë profesionale ta shqiptojnë në ligjërimin publik, në rastet përkatëse të hetimit periodik e të sistemimit të vlerave, prurjeve.

Motivacioni i vlerësimit për ju nga fondacioni "Harpa" ishte: "Shkrimtar me vlera të larta krijuese. Autor me individualitet krijues që ka krijuar kode unike ligjërimi, duke pasuruar prozën romanore shqipe." Keni një vështrim për këtë të fundit, pra prozën shqipe bashkëkohore, çfarë po ndodh?

Proza shqipe po vazhdon rrugën e saj me autorë të mirë. Krahas klasikëve të gjallë, si Kadare, për shembull, kemi edhe breza pasardhës që e kanë krijuar fizionominë e tyre dhe po e pasurojnë biografinë krijuese me vepra të reja, duke botuar rregullisht libra interesantë. Madje dhe autorë me moshë fare të re po kalojnë me guxim e sukses te gjinia e romanit duke mos zhgënjyer. Për fatin e mëtejshëm të romanit tonë si vijimësi nëpërmjet shkrimtarëve debutues shpresoj të na vijë në ndihmë bujaria e botuesve tanë dhe zelli shkrimor-flijues i vetë autorëve që t'i mbartin me durim faktet e hidhura që vijnë nga realiteti ynë social, aspak i favorshëm për punë artistike, mjerisht.

Romani juaj "Pëllumbat i vrasin natën", ashtu siç jeni shprehur, është një dëshmi e përjetimeve, bilanc intelektual shpirtëror për realitete komplekse historike. Ka pasur "keqkuptime" në perceptimet e tij dhe kemi debatuar për këtë. Çfarë ndodh në këtë rast, kur vepra shkon te lexuesi, sa është i riskuar shkrimtari për t'u kuptuar ose jo? Sa mund të jetë i shqetësuar shkrimtari për këtë?

Bashkë nuk kemi pasur keqkuptime për romanin, por për mënyrën e etiketimit të tij për tregun e librit, e këtu formulimet janë përherë të lëvizshme, asnjëherë të mjafta për ta rrokur a shpalosur krejt librin e thelbin e tij për lexuesit nëpërmjet një etikete, nëpërmjet një fraze marketing. Libri po pëlqehet dhe po lexohet me ëndje. Më kanë ardhur vlerësime të shumta, pozitive, madje entuziaste: është pëlqyer mjaft si histori tragjike e një familjeje dhe e një individi; është pëlqyer humori i zi me të cilin ky fat individual e familjar bëhet miniaturë simbolike e krejt shoqërisë sonë për periudhën nga fundi i shekullit të shkuar deri në ditët e tashme. Nuk jam provokator, por as e ul veten në rolin e një shërbyesi restoranti, që pjatën e qortuar nga klientët ta tërheqë për ta rikompozuar sipas shijes së masave; përkundrazi, kam ngritur një forum timin, një radhë romanesh si lartësim e kristalizim të personalitetit tim, shkrimin, dhe nuk mund të zbres në nivele shprehie pragmatike që nuk më përkasin mua për nga cilësia e autoriteti.

Sa "luks", aq edhe mundim më duket fakti se rrëfimi juaj është përjetim, të shkruash në përjetim… dhe t'i hedhësh personazhet në honet e një historie, në të vërtetat e tyre…

Vij nga poezia, vij nga përjetimet e imëta lirike dhe nga shkolla e jetës së vështirë; përvoja e gjatë krijuese, forca e karakterit, formimi intelektual mbase më kanë ndihmuar të ndiej e të shkruaj me zemër, por edhe t'i vendos zemrës një copë akulli përsipër kur konceptoj një vepër, gjatë formësimit të saj.

Si është krijuar ky roman, si ka lindur?

Është shkruar në dy muaj të verës 2013, menjëherë sa kisha shkruar në variant të parë romanin *Stina e hijeve*. Pra, ishin 3-4 muaj çmendurie të vitit të mbrapshtë 2013, në kuptimin përkëdhelës të fjalës. Nuk u habita kur e përfundova aq shpejt, u mërzita se po ndaheshim bashkë. Meqë m'u bë i dashur si tekst, vendosa ta mbaja ca vite për vete, ndaj kam refuzuar disa mundësi të

mëparshme botimi. Më tepër nuk tregoj dot tani për tani...

***Neta* është simbolika e gjithë romanit: falë shoqërisë me pëllumbat, i ka shpëtuar izolimit, vetëvrasjes, çmendurisë… Ka një "pavarësi" të frikshme, që krijon një model, që na lë në një trishtim… çfarë brengash qëndrojnë në ju, sa identifikim ka ky personazh?**

Sa i përket Netës, ajo ka dy çaste të rëndësishme zgjedhjeje për shokun e jetës, për shokun e shortit. Në rininë e saj të hershme, kur sheh për herë të parë Betimin, me të cilin pati dashurinë fatkeqe, martesën e parë dhe djalin, Vegimin, ajo tha: "Sa shumë e dua ushtarin"; ndërsa, kur ngeli e ve, ajo u martua me dikë vetëm për faktin se ai mbante pëllumba në shtëpi, në ballkon. Kështu, nga dashuria marramendëse për rrobën ushtarake, tek ajo verbuese për pëllumbat – kemi dy pikat fundore të një segmenti tragjik-grotesk, por dhe sintetizues: metaforë e vendit tonë për shtrirjen kohore-historike përkatëse.

A keni një mendim, pse vazhdon ende letërsia të prodhojë libra mbi kujtesën?

Libri është pjellë e kujtesës; edhe imagjinata, përfytyrimi i çdo gjë tjetër që përfundon në lëndë romanore, është prej thesareve të fshehta të kujtesës. Ju e keni fjalën për një narrativë të modës së fundit: periudha komuniste, dëshmitë për të, seminaret, simpoziumet... Ato janë angazhime deri-diku formale, sa për procedurë, sa për të tërhequr fonde a për të shlyer formularë shpenzimesh e detyrimesh financiare. Kujtesa e romanit dhuron gjak për lexuesit, nuk ka të bëjë me ato që ju me të drejtë konstatoni.

Të ruhet dashuria për Njeriun dhe dhimbja për dhimbjen e Tjetrit. Ky është një ndër postulatet humane që del nga libri juaj. A mendoni se intelektuali human ka "vdekur" sot, apo nuk i hyn më në punë historisë, vendit, letërsisë?

Asgjë nuk ka vdekur e nuk mund të vdesë, as e keqja as e mira, vetëm ndryshon raporti midis tyre, herë mbizotëron njëra, herë tjetra; kuptohet, te ne e keqja ka pasur përherë epërsi absolute duke u ngritur deri në përmendore. Njerëzorja, e mira, e dëlira do të jenë gjithashtu sfiduese, element bazik i jetës, themel i ekzistencës. Problemi qëndron te modelet që ofron/ shpërblen/ propagandon shoqëria, shkolla, sistemi politik-shtetëror.

Cila ka qenë këshilla më e mirë në shkrimin e këtij libri? Në fakt, me këtë pyetje ndoshta dua të ngre një nga problemet më të mëdha që ka shkrimi i librave këtu, askund nuk flitet për prezencë të një mentori letrar…

Nuk mund të ketë shkrimtari mentor në atë kuptim që e ka kërkuesi shkencor, doktoranti, studenti që po përgatitet të kryejë një studim... Kam përshtypjen se shkrimtari lind kur shpërfill mitet, idhujt, modelet, mentorët e përfytyruar, kampionët e fushës së tij; shkrimtari lind kur fillon t'i nxjerrë në dritë përmbajtjet e tij, tundimet e tij, makthet, habitë, zhgënjimet.

Në çfarë mënyrash i "shërbeni" librit tuaj? Sa udhëtoni, sa i ndiqni festivalet dhe ngjarjet letrare… në këtë kontekst.

Për shkak të profesionit, lexoj; lexoja edhe kur isha i vogël e nuk e kisha këtë profesion; tani kam mundësi të lexoj pothuajse në kohë reale librat që bëjnë emër në botën e madhe letrare. I lexoj për kërshëri e kënaqësi njerëzore-estetike, jo për t'i zhbërë me mendje, si ata që duan të vjedhin sekrete të prodhimit, të teknologjisë. Asgjë nuk kam bërë për hir të letërsisë sime a në dobi të një libri që mund të shkruaj ndonjëherë: kam dashur të shoh sa më shumë që të kuptoj sa më mirë veten, pozicionin tim në kohë e në hapësirë; kam dashur të ndiej sa më shumë si njeri natyrën dhe historinë; kam dashur të prek sa më shumë pamje të fateve të nëpërkëmbura njerëzore, pamje të heronjve anonimë.

Ende kritika s'ka shkruar për librin tuaj, ndoshta nuk e kanë lexuar apo nuk marrin mundimin të lexojnë më sot?

Kritika nuk mund të bëjë përjashtime e të ndryshojë zakon kur fjala është për krijimtarinë time: nuk do të shkruajë as kësaj here. Romani im i parë ka 25 vjet që është botuar e njohur në Shqipëri dhe 18 vjet i botuar në Francë, por për të në Shqipëri nuk ka pasur kurrkush "guximin", fisnikërinë, korrektesën profesionale t'i shkruajë 18 fjalë, jo 18 fjalë nderimi nga ato që i kanë me tonelata për njëri-tjetrin, por fjalë analizuese-kritike… Jo. Nuk e kam matur ndonjëherë veten me mendjengushtësinë e tyre. E kam kapërcyer atë nivel ndjeshmërie e atë horizont buburrecësh që kur vendosa të dorëzoj për botim librin e parë; tashmë, jemi 10-11 libra më larg…

Ju gjithmonë keni qenë një nga kritizerët më të ashpër të çmimeve, duke anatemuar sidomos mbi kriteret e ngritjes së një jurie. Çfarë ka për t'u ndrequr në këtë aspekt?

Shakatë apo qesënditë e mia nga tavolina e kafenesë apo nga *facebook*-u m'i kanë marrë e ekzagjeruar gazetarët e etur për sherre, ngatërresa, konflikte verbale. Jam njeri i humorit të shkujdesur, i humorit argëtues e pa të keq, e jo njeri i sherrit, aq më pak nuk jam ushtar i nihilizmit. Sigurisht, jam shprehur dhe në mënyrë të posaçme, serioze, për këtë problem jurish e juristësh letrarë me dëshirën normale që akordimi i një çmimi të na e shtojë respektin për shkrimtarin, për veprën e tij e jo të na shtojë të qeshurat, dyshimet, përqeshjet. Kaq kam dashur.

Intervistoi: Violeta Murati

"

Proza shqipe po vazhdon rrugën e saj me autorë të mirë. Krahas klasikëve të gjallë, si Kadare, për shembull, kemi edhe breza pasardhës që e kanë krijuar fizionominë e tyre dhe po e pasurojnë biografinë krijuese me vepra të reja, duke botuar rregullisht libra interesantë. Madje dhe autorë me moshë fare të re po kalojnë me guxim e sukses te gjinia e romanit duke mos zhgënjyer.

Letërsi/ Një cikël me poezi shkëputur nga antologjia e poetëve shqiptarë bashkëkohorë, hartuar nga shkrimtari Romeo Çollaku në dy gjuhë, shqip-greqisht. Një brez që u largohet klisheve soc-realiste, ku përmes ndjeshmërive intime, krijojnë atmosferën letrare si psikë estetike, liria gjuhësore është kufiri konkret dhe i prekshëm si në metaforë dhe simbolikën e një real-strukture që përmbysi totalisht normat standarde të trashëguara.

POETËT SHQIPTARË BASHKËKOHORË NË ANTOLOGJINË GREKE

AGRON TUFA
ORFEU

Jeta jote - burgosur aq mirë,
mbështjellë puthitur e pa drojë
me fletët rrotullame të një qepe
e flijoi, ah, thelbin e vet
me të mshehtat e mbrame –
kur tehu i thikës feksi
ngulmueshëm, duke grirë
zemrën tënde të njomë –
topitur erudicionesh fiktive.

Lotët e Euridikës në kuzhinë
s'kanë tjetër shkak
pos faktit
që ti je i vetmi ingredient lotsjellës
në sallatën e rëndomtë familjare.

* * *

ARJAN LEKA
VAJTIM

Qielli
Kam frikë
po kam frikë se një ditë
retë e bardha që ndalën befas mbi qytet
sikur mbollën aty ganxhat e lara
kam frikë,
kam pak frikë
se ndonjë ditë
pa qenë vjeshtë
do i ngrenë ganxhat
kam frikë
do të shkojnë gjetiu
do të na lënë vetëm.

Toka
Kam frikë
po po kam frikë
kur hëna të jetë krejt e re
këta ishuj që na ndenjë pranë
kam frikë
në heshtje të thellë pa nxjerrë zë
dhe pa ne atje
po po kam shumë frikë
siç erdhën
do të ngrenë spirancën
dhe do të na lënë vetëm
sërish.

Deti
Kam frikë
sa frikë frikë
se këta ullinj të lashtë
ndonjë ditë
kam frikë
sa frikë
kur në gjumë të jemi bashkë
kam frikë
sa frikë kam
se do i kërrejnë jashtë kërcinjtë
do ngrenë rrënjët
siç ngrenë plakat dimitë
para se të hyjnë në varkë
kam frikë
kam frikë se shumë fjetëm
do të na ikin dhe këta ullinj
e do të mbetemi fill krejt vetëm.

ARBEN DEDJA
NJËRËS QË QAN PËR GJIRIN QË DOTË HEQË

Mos u bëj kryeneçe,
si dhi manjë.
Gjiri, ai i mbeturith:
më i çmuari për ne.
Ta dish ti ç'silikon
ka nëpër sisë topmodelesh,
nëpër sisë pornostaresh
do t'i mbushnim tërë
plasat e dritareve tona
ku era e trishtimit fryn.
Dhe prapë ëndërrojmë t'ua cikim
dhe prapë fotografët mblidhen rrotull
se të tillë jemi ne burrat:
nuk prekim gjirin tuaj
po idenë tonë për të.
Duhet ta jetojmë bashkë
këtë store sa të mund...
Shko me të mira, cicë,
po të jap një të puthur të fundme.
Bye.

* * *

IDLIR HAZIZI
GRUAJA MË OFRON NJË PJESHKË

Gruaja më ofron një pjeshkë dhe më pyet
pse po qesh. E ka qëruar pjeshkën
sepse e di që më jep alergji lëkura. Më vonë e pashë
të kruspullosur lakuriq në shtrat ndaj u ngrita
dhe i shkrova një letër Jorie Graham-it:
"(a woman whose body is the limit of every peach)"
pasi vështroj qiellin natën
dhe nuk e kuptoj fare mënyrën sesi është vendosur
dritarja,
më saktë, e kuptoj: është hera e parë që
më shkon ndërmend diçka e tillë, Hamleti, mendoj,
duhet të kishte ndenjur më gjatë në errësirë
dhe pastaj të martohej, mendoj,
Hamleti është varri i gjeometrisë; por u bë ftohtë,
ndaj e mbyll dritaren dhe eci mbrapsht
deri te krevati dhe mbaj vesh për ndonjë fjalë
të re që mund të jetë në rrugë e sipër prej pasqyrës;

ILIR BELLIU
FËMIJA QË RRODHI NGA MURI

Ligështues
fëmija ideal
që rrodhi nga muri.
Djall fëmijë!
Kurrnjëherë s'më neveriti
në të gjitha ngjyrat...
Fëmijë
si çdo fëmijë
zog elektrik efekti
burrë ekziston
në orët magjepsëse të rrëzimit...

* * *

LINDITA ARAPI
NJERIU NË ANËN TJETËR

diku prapa murit
duhet të vijë ky zë...
herë vjen si një rënkim që
dobësohet,
herë më bëhet se është
një këngë e trishtuar nate,
zëri stonon, bëhet i paqartë,
vibron
si një zë që përpiqet të kuptojë
nuancat e vuajtjes së vet,
nuk jam e sigurt...
më duket se ai zë
është këngë e përkryer dashurie.
nuk e di nëse dikush këndon...
nuk e njoh as fqinjin që banon në
anën tjetër.

* * *

PARID TEFERIÇI
POETI

Më qëllojnë ku nuk jam.

Qëllon që më ngrenë dorën nga tryeza
me pa mos jam fshehur aty.
Qëllon që më duhet t'i hap rrugë
ndokujt që ngutet me më gjetë.

Qëllon që më ndezin
për të më kërkuar në errësirë.

Sido që të rreshtohem para murit
nuk më qëllojnë dot.

* * *

LULJETA LLESHANAKU (1968)
NJERËZ TË TRADHTUAR

Gra të tradhtuara, si numri i vjetër i këmishës,
si vrima e vjetër në rrip të pantallonave,
si jakat e hekurosura me kollë.
Gra të tradhtuara që gdhijnë si një sklepë
në buzë të shtratit
të trembura nga një ëndërr e keqe,
samovarë që lëshojnë avull
kohë pas heqjes nga zjarri.

Teksa lëvizin diagonal nëpër shtëpi
këllqet e tyre të buta harkohen ritmikisht
sikur mbllaçisin milingona.
Fëmijët... ah, fëmijët, shkumëzojnë ajrin.
deri mbrëmje vonë, kapakët prej alumini
kondensojnë mbi nervin e ngordhur të majdanozit
në supën e paprekur ngjyrëlimoni.

Por, ka edhe burra të tradhtuar
burra të tradhtuar si engjëj të zeshkët
me shpatulla gjithmonë të rrezikuara nga fieret.

Burra dhe gra të tradhtuar
që shpesh fatin e pranojnë ashtu siç u jepet,
pa e kthyer mbrapsht, fisnikërisht,
siç mund të pranohet uji në një gotë të palarë,
në udhë e sipër
Gra dhe burra të tradhtuar...
të nisur për një udhëtim të gjatë.

* * *

GENTIAN ÇOÇOLI
BANORË TË 1995...

Banorë të 1995-ës. Jo shumë larg nga këtu,
dëgjohet një sirenë e kohës sonë,
mandej krisma, kuja, heshtje e kuptueshme.
Dhe prapë e gjitha nga e para.
Ka nisur sezoni i njeriut.
Edhe më larg nga ne akoma,
një pyll i moçëm, plot vëmendje, i vrenjtur,
ka akoma fuqi të mbyllë dyert e veta të rënda.

Këtë herë për fare

* * *

ROMEO ÇOLLAKU
MENDUESHËM

Mjegull dhe kumbulla të zhveshura dhe madrigale
shiu mbi çati,

atje ku plakat u kallëzojnë fëmijëve përralla e balada
plot numra fatidikë; lugën ua afrojnë te goja
gjithë përgjëratë e ëmbëlsi: Shpejt, se vjen
Dhëmbëhekura! Çakejtë rendnin mes dëborës,
fshatin të rrethonin! Burimin e kish zaptuar
Lubia e harbuar.

Tre male, shtatë kokë, nëntë djepe...

Dhe fëmijët binden edhe hanë, duke u përtypur
ngadalë e në përhumbje, me vështrimin tretur pas
xhamave të vagëlluar.

ERVIN HATIBI
TOO DRUNK TO...
(Dead Kennedys)

Tani disponoj edhe seksin tënd

jam i lejuar ta prek
i lutur ta hukas

E ke të thjeshtë ti
Thjesht rri shtrirë në krevatet e mia
dhe urdhëron të pushojë muzika
të fiket drita
E qesh përtej mjekrës tënde me dhëmbë
si edhe përtej
Amfiteatreve të fytit
sytë e shtrirë, e bardhë, e bardhë...

Pastaj barku yt me faje tërheq
vrraga të trasha
ajri
Ti po e punon me shatë ajrin e dhomës sime
unë sillem nëpër dhomë si Lenini
bythët e mia të zhveshura në terr
janë dy o-të tek fjala alkool
E ty të këputet shpirti
qesh...
Me cicat e tua prej qeni, kur unë të them
se lipset të kesh edhe një palë të tjera si këto
Cica qeni që i kanë varur sytë njëra djathtas
tjetra majtas
si në flamur
(pushon e qeshura, ato pushojnë së duartrokituri, cicat)
(bëhet heshtje):
ti kërkon pa u ngritur cigaret
Që i mban në çantë
ku ka edhe plot gjëra të panjohura grash
Zhurma e çakmakut tremb barkun tim të vdekur
i shkurtër ndriçimi, dihet, si një valë
fshin shpejt figurën tënde nga rëra e syve të mi
Atëherë unë shtrihem pranë teje
kjo cigarja si fëmijë pleqërie, ose si ndonjë gjë
tjetër më e saktë që i lidh dy vetë
edhe po s'qenë aty të dy
Fjalët e tua janë rrethuar nga një zë i padëgjuar
ti më thua mes tingujve se s'duhet të të thërras më
-Kur je i pirë... -shton
Asnjë e dhënë tjetër pastaj
për trupin tënd, a je shëndoshur më
ai ke krejt vetullat
Thonjtë e mi
rriten
janë ngulur në djersë
në Viet-Namin tënd të rruar pa napalm
Ti qesh megjithatë me tym
Dhe unë ta di emrin
E ti nuk do që unë të trishtohem
Ndaj
më pickon herë-herë
në një nga bythët e mia të ligura
si mollëzat e poetit me tuberkuloz
E asgjë
s'më ndalon të qaj vetë
mos lër të ulen sytë e mi.

LEDIA DUSHI
THONA...

Thona
se s'dina me dashtë,
ikjen
kena shans,
largësinë;
mija mjegulla n'ajr
mos me e ndie
çka na sjellin
ndër veshë.
Murin
gjuejmë me gota,
e Zotin
me «Zoti s'asht».
Na dhimben lott.

LULE

Prej detit
shi puthjesh...

Vorret s'maten
me trandofila,
as me bajamet
e syve të tu
t' mbytun
n' prehën t' dhetorit.

T'rrënqethet trupi
nën rradhët e avullt
t'gropëhanës.

Nata t' kalon prej fundit,
nëpër shpirt...

Lulja
sheh lulen n'ty,
e fiket.

* * *

VIRION GRAÇI

***
Ta ndajmë bashkërisht
kartmonedhën që gjetëm
në plehërat e qoshkës.

Ta ndajmë bashkërisht
statuetën që gjetëm rastësisht
në cepin e dollapit.

Ta ndajmë bashkërisht
jorganin që gjetëm të hedhur
në këmbët e betonta të urës.

Ta ndajmë bashkërisht
shegën e shkoqur nëpër qiell.

Dhe do të jemi
më të pasur se mbrëmë,
më të varfër se nesër.

*
Të të kem larg - mundësisht
sa më larg. Dhe të më vijë e vetme
fëshfërima e zbehur e kurmit tënd,
kërcitja e butë e sandaleve mbi zhur.
Vetëm fëshfërima e flokëve të më vijë.
Nëse është e realizueshme - zëri yt të mbyllet
në shishkë - dhe të hidhet sa më parë në det.

"Takohemi përtej një libri" – një grup artistësh, studentë dhe dashamirës të artit në qytetin e Durrësit janë mbledhur në 20 dhjetor, në Torrën Veneciane, në një bashkëbisedim mbi librin e fundit të artistit Vladimir Myrtezai, "Zahiretë" – një libër mbi fenomene, vëzhgime, profile dhe intervista që prekin artin me kompleksitetin e formave, dhe marrëdhëniet me audiencën, duke na shpalosur konturet e jetës publike e akademike të autorit. Më poshtë kemi shkëputur një nga vështrimet më interesante e më shqetësuese të Myrtezait çfarë ka ndodhur pas '90-ës, nga kjo distancë, me lirinë e artistit...

ANARKIA SI LIRI SUPREME

SHENJA NGA BREZI I ARTË

Nga Vladimir Myrtezai

Të etur për liri, vijimi i viteve nëntëdhjetë do shënonte kulmin e një kalimi të lartë në përjetimin e stadit elementar të të qenit i lirë në një vend ku mund të ndodhte gjithçka. Të derdhur në të drejtën për të rimarrë pozicionime që rrjedhin nga vullnete vetjake, i madh e i vogël u lëshua në një vetidentifikim masiv e marrosës në luftën e madhe për të jetuar një tjetër status, të pakontrolluar tashmë. Ngjyrime, transformime dhe cytje nga më të papriturat kundër çdo konvencioni që disiplinon mundësinë njerëzore për të ndezur një ëndërr, një shans.

Të gjithë bashkë, të dekontraktuar, të derdhur, njerëzorë, në sfidë, flirtues, shkatërrimtarë, poetikë, vandalë, të uritur, seksomanë, guximtarë, trima të shkalluar, asketë e lundërtarë të poezisë së gjallë në rrugë. Kjo ishte panorama që sundonte rrënajën populiste të atyre viteve.

Parë nga një mungesë baze dhe edukimi, përballë mundësisë për të realizuar një ëndërr qëndronte tehu kryesor e në ngut në axhendën e gjithkujt. Në kërkim të të gjitha shenjave, lënë pas në fis e farë dhe në të gjithë rremat e fshehur të identiteteve në kërkim, të gjithë kundër të gjithëve, e manifestonin të qenit gjallë plot fuqi e ndjenjë për të pushtuar çdo hapësirë të mundshme. E kush nuk do të donte të gjendej në një skenë të tillë apo në një përmbysje të madhe, qoftë dhe me statusin e dështmitarit, për ta rrëfyer më pas këtë rropamë ngjethëse, kur gjërat ndryshonin me ditë dhe njerëzit konvertoheshin pa mundësinë e një testi në kohë.



Fillesa shënoi njomjen e dorës me rrëmbim të parave të para që mund të fitoheshin lehtësisht në bursën e rrugës. Nxorën kokën paratë e para me fajde dhe tregtia e rrugës, tregtia me gjithçka, jashtë çdo rregulli loje. Një qejf i madh në skamje, ku mund të hidhje si vlerë tregu çdo gjë, duke filluar nga trupi, sendet, pasuritë e luajtshme e të paluajtshme e ç'të të kapë mendja e dora.

Nga një hierarki e varfër e skematike në opinionin publik, filluan të shfaqeshin kapërcimet e para dhe diferencat njerëzore, ku çdo gjë po hynte në xhepin e individit dhe kurrë më për të mirën e përbashkët, një nocion të cilin donin ta shkulnin me rrënjë, ngaqë e ndërlidhnin me regjimin pararendës. Në shfaqje të tripluara në skenën shoqërore gjallonte ende kriza e rezistencës në komunitetin e artistëve, duke dhënë shenja jete si pjesa më e ndjeshme e një shoqërie, që në përmbajtjen e saj kaloi një nga krizat më të rënda të ndërgjegjes, veçanërisht ata që e kishin konsoliduar shenjën e tyre agresive në memorien publike.

Artet pamore kishin pësuar shembjet e para dhe ishte tronditur e gjithë skena, pasi kish humbur "përmbajtjen" e gatshme me të cilën ushqehej. Për shkak të përmbysjes, ripozicionimet e para u paraprinë nga një lloj lëvizjeje si underground, që kish nisur që në vitin 1985 me rebelime sporadike, por të dukshme, të talenteve që nuk po u përmbaheshin dot kornizave nënshtruese dhe të përziera me një kompromis që lëngonte në shtratin e përsëritjes.

Më vonë pata vërtetuar që në frymën e këtij ndryshimi kishim kuptuar se një lëvizje arti ishte perpetuum mobile, që nuk kishte gjithnjë nevojë për përmbysje totale, pasi kjo ndodh vetvetiu në ndërgjegje të larta e të ndjeshme, si një ndryshim pa kthim. Por, sfondi i madh i përmbysjes i dha një hov të ri e të paimagjinuar kujtesës dhe lirisë së këtyre krijesave që, në fakt, kishin lindur të ndryshuara apo në një modus kërkimi për t'u vetëkryer. Gjithsesi, në këtë rropamë duheshin "vrarë" idhujt dhe duheshin rilindur parashikuesit e së ardhmes. Qe një ngërç historik që, në njëfarë leximi linear të historisë, do të quheshin pushtuesit e rinj, të favorizuar për t'i dhënë kuptim një shndërrimi të ri e tejet të distancuar nga një e kaluar që të ngarkonte me ndjesinë e fajit. Faza ndërmjet viteve nëntëdhjetë dhe dy mijë ishte dështmi e një tranzicioni të fortë e traumatik që, në fakt, lëvizi dhe u dha të gjitha bazamenteve kulturore një mundësi për të përqafuar një ndryshim që zakonisht ndodh një herë në njëqind vjet, si një kafshatë e fortë, por edhe si një gjetje e fatit të individit për të përjetuar e për t'i dhënë kuptim një lëvizjeje që dekodifikon një identitet unik. Gjithsesi, në vijën e parë të këtij ndryshimi, siç ndodh në të gjitha përmbysjet, kishte edhe keqkuptime të mëdha, që morën formën mikluese të ëndrrës dhe u panë si beteja të larta të përqafimit të një lirie pa kushte.

Vështruar nga një distancë e mjaftueshme, rreth dy dekada e gjysmë, e gjithë kjo rropamë të shkakton ndjesinë e një shkulmi morboz të ngjyruar nga personazhe ëndërrimtarë, që në emër të lirisë dhe fjalës së lirë e gjetën veten si yshtarë që nuk ishin të sigurt nëse do të mbeteshin në histori apo kjo e fundit do

t'i zvogëlonte shumë shpejt, si një fllad ere në një pikë të horizontit. Kjo e ndihmoi lëvizjen për të ndryshuar, ose thjesht për të qenë pjesëmarrëse në një kohë me interesa të zhvendosur ftohtë, pa mëshirë.

Sidoqoftë, në një vështrim të shpejtë, shumë njerëz jetuan kohë domethënëse dhe faktuan ripozicionimet me veten, si dështmitarë apo protagonistë me vlerë, gjë që i ekspozoi ndaj një gjykimi të hapur, qoftë edhe përballë mundësisë për t'u fshirë nga historia.

Ky shkrim merr një ngjyrim shtesë për ata që kanë lindur "në të ardhmen", pa një të shkuar të tillë, ku do të kishin mundësinë të shijonin efektet e një kaosi apo të një anarkie si një ngjarje e madhe që kaloi vendi ynë, me personazhe që – pa modesti – mund të quhen aktorë të kohëve të arta. Askush nuk mund ta mohojë që përveç shkaqeve objektive, sistemi komunist nuk mund të binte si një skenar i lehtë dhe si në një deja vu ekranesh. Çdo gjë pati shkaqet dhe protagonistët e saj, që në një alarm të panatyrshëm ëndërruan se një moment po bënin histori. Nëse nuk do ishte ky delir i nënshtresës njerëzore apo kjo prirje e kushtetutës së brendshme, nuk do të kishte asnjë lloj ndryshimi. Në rregullat e pashkruara të ambicies e genit njerëzor do të ndizej një flakë që do të zgjaste gjatë, për të zënë vend në raunde të pandalshme zhvillimi. Në këtë sfond anarkie e kaosi do profilizohej edhe historia akoma e padokumentuar e disa njerëzve, që në vend të një interesi material, u dhanë e u sheshuan pas ideve, pasi u duk se erdhi momenti për t'u barazuar së brendshmi me fuqinë e egos dhe të sakrificës që, krahasuar me interesin ditor në rritje, ngjante si një ëndërr e zhubravitur.

Shumë artistë të pakryer dhe të tjerë në trend kohe, nxituan si në jerm që të shënjonin një turravrap të pazakontë: të shfaqen në një ekspansion të padë-gjuar e të pashkruar për nga irracionaliteti dhe zëri i instinktit, duke rrokur e afruar pjesë të veçuara të publikut; duke shfrytëzuar një uri të papërmbushur të tij. Një hare jashtë çdo imagjinate.

Për shkak të ndrydhjes së ushtruar mbi lirinë e shprehjes, tanimë mund të fluturonte çdo gjë, si

hapësirë e pamatë dhe e pakorrektueshme nga asnjë lloj sistemi vlerash. Kështu vazhdoi për një kohë të gjatë një ëndërr mes ëndërrimtarësh që shiteshin e bliheshin në një qark krejt të mbyllur e pa rregulla loje. Në këtë çakordim masiv u bënë të lexueshme profile të reja që s'i kishin lënë akoma atelierët e Akademisë së Arteve e cila, në fakt, ishte kthyer në një laborator mundimi për të ndarë mjeshtëritë nga format e reja të perceptimit, ku të talentuar e rrokës të apasionuar të dijes u kthyen në një digë për lumin e kohës, për t'i dhënë njëfarë kuptimi ëndrrës, si dhe për t'i shtruar disi me ngut strategjitë e reja se çfarë mund të ndodhte me lirinë krijuese; duke vënë kështu në krizë ndërgjegje të holla dhe ndjeshmëri të gatshme për të qenë të hapur e sfidues.

Klod Dedja, Anri Sala, Alban Hajdinaj, Altin Lika, Gent Gjikopulli, Rovena Agolli, Edit Pulaj, Eri Daka, Flor Haxhihyseni, Suela Allmuça, Diana Mato e më pas të tjerë, si Doris Sala, Ilir Dupi, Edison Çeraj, Rudina Hyka... – të gjithë të çmendur, pa kompromis; ëndërrimtarë të pakrahasueshëm, parakalonin të tashmen të tërhequr nga graviteti i së ardhmes. Qe një brez i ardhur posaçërisht si faktor ndryshimi, bashkëpunues për të qenë në mbështetje të thellë të një shndërrimi sa më vital për kulturën pamore. Ishte brezi i ashtuquajtur i artë, sepse e ngritën në një stad të ri e të pjekur thellësinë e të menduarit dhe pikat e përafërta të referimit. Një kohë e lumtur e mbushur me energjinë e ndryshimit, por edhe me supozime të mbetura si një arkiv i vyer për të dëshmuar këtë ndryshim. Klod Dedja apo Kloshi, siç e thërrisnim në afri, ishte magjia e parë e ndryshimit në ato vite, ku pa dyshim që i tejkaloi të gjitha standardet akademike me një pjekuri të lartë e me një instinkt të ngulët. Anri Sala, me elegancën dhe racionalitetin e zhvillimit të konceptit, duke na asociuar e vënë në krizë edhe vetë ne artistët që bënim zë në atë kohë. Apo Alban Hajdinaj, Parid Çefa e Astrit Vatnikaj, që yshteshin në thellësi të pamata, me shenja të forta (ri)zbuluar nga e shkuara identitare e tyre. Pastaj befasitë ndërlidhëse në medium, akoma të panjohura për publikun, të Altin Likës, Rovena Agollit, Gentian Shkurtit e me radhë.

Por, e gjithë kjo skenë në lëvizje e gjakim të lartë në zgjedhje, bërje e zhbërje në distancë, afri të mrekullueshme në flirte e me dashuri të përziera, nuk do kishte kuptim pa nxitësit e formuluesit e saj; pa lëvizjen kyçe të viteve nëntëdhjetë, ku faktori popull do zhbënte një skenë të ngulitur për shumë vite, jofunksionale tashmë; pa zdërhalljen trysnishumë të Edi Ramës, që pozoi si kryelëvizës alarmant i kohës, mbi të cilën u shtri gjerë e gjatë me trajektoren se ky vend duhej bërë. Pa harruar këtu elegancën e rafinuar të Ardian Klosit, Teodor Kekos, Rudolf Markut, Bujar Xhaferrit, Shpëtim Nazarkos, Arben Imamit, Tos Baxhakut, Agim Isakut, Xhil Muçit, Gaz Lekës, Ilir Pojanit, Pjerin Kolnikës, Skënder Buçpapës, Bardh Londos e shumë të tjerëve, me të cilët po më vë në siklet kujtesa. Po ashtu, e gjithë kjo nuk do të kishte kuptim edhe pa qëndrimet skeptike në territorin e njohjes nga murgjit e heshtur: Petro Zheji, Jusuf Vrioni, Danish Jukni, Franc Ashiku...Duhet kujtuar këtu edhe sfondi i butë ndarës në gropa të padukshme dashuri-urrejtje i femrave protagoniste: Moza Ahmeti, Najada Hamza, Ornela Vorpsi, Anisa Markarian, Monda Bulku e me radhë. Por, për më tepër nuk do të kishte kuptim pa memorien e njerëzve që u radhën në këmbim të një realiteti të stërpërfolur mbi qëndresën dhe vuajtjet e tyre në një peshë të çliruar tashmë të vlerës e protago-nizmit si mur i heshtur: Fatos Lubonja, Ali Oseku, Edi Hila, Edison Gjergo, Daut Gumeni, Maks Velo, Frederik Rreshpja, Visar Zhiti, Ejëll Çoba, Musine Kokalari, etërit katolikë Dom Simon Jubani, At' Zef Pllumi, Vinçes Prenushi, Lazër Shantoja, At' Bernardin Palaj e shumë të tjerë. Do të duhej një mur i madh emrash për ta ligjësuar në një peshë specifike këtë faktorizim të kohës që jetuam, si një anarki e lartë në një dialog e kundër-dialog përjashtimesh ku u ndërtua kaosi dhe përmasa e stërmadhe e "shndërrimit të të gjitha vlerave", si një nevojë njerëzore për ta jetuar kohën duke u shfaqur në pafajësinë që mëkëmb të qenit dëshmitar. Sot, si më ftohtë, nga larg e në pozicione të konso-liduara, vështrojmë më ashpër për të dëshmuar kohën e festës së madhe kur flakej arsyeja dhe vendin e saj e zinin sërish kampuset e pashmangshme të parastësisë e racionalitetit, për të kuptuar derdhjen e paparë të instinktive të zgjedhjes fillestare, që u shkaktua ndër njerëz që shijuan lirinë në hurth të parë.

NË FOKUS

Fituese e Këngës në RTSH

JONIDA MALIQI NË EUROSONG 2019 ME "KTHEJU TOKËS"

Këngëtarja Jonida Maliqi me këngën *Ktheju tokës*, me tekst dhe muzikë të ErionaRushitit, u zgjodh fituese e Festivalit të Këngës. Në garë ishin 22 konkurrentë, mes të cilëve edhe këngëtarë të traditës.Disa prej tyre, si Eranda Libohova dhe vetë fituesja, shënjuan në këtë edicion të 57-të rikthimin e tyre në skenën e madhe pas shumë vitesh.

Me këngën *100 pyetje*, me tekst të Pandi Laços dhe muzikë të Gent Myftarajt, Libohova arriti që të fitojë Çmimin e Medias dhe u rendit vendin e tretë. Gjithashtu në këtë festival u evidentuan përballë zërave profesionistë edhe zëra të rinj, si Dilan Reka, Klint Çollaku, MIRUD (Durim Morina) dhe Lida Lufi, e cila u rendit e dyta në garë, me *Rrëfehem*, kompozuar nga Enis Mullai.

Tekstin e kësaj kënge e ka bërë vetë artistja e re, ku ka shkruar eksperiencën e saj personale, duke rrëfyer marrëdhënien e saj me Zotin dhe këndvështrimin për jetën. Një këngë tjetër tepër emocionuese e sjellë nga dy zëra të rinj të talentuar ishte *Leyla*, nga Marko Strazimiri dhe Imbro,që arriti të rrëmbejë Çmimin e të Rinjve. Kënga ka në fokus historinë e një vajze 14-vjeçare që mëson se do të bëhet nënë dhe vendos të mbajë fëmijën.

Jonida Maliqi rikthehet me një këngë që trajton një temë me sensibilitet të veçantë veçanërisht për shqiptarët, emigrimin. "Ktheju tokës tënde" bëhet njëkohësisht një thirrje për të larguarit.

Ajo ka treguar për mediat se kënga do të jetë në shqip edhe gjatë kompeticionit në Eurosong në Tel Aviv. Sipas kompozitores, për vetë tematikën e këngës këndimi në gjuhë tjetër nuk do të ishte i përshtatshëm, pasi edhe teksti ka në fokus tokën amë.

Festivali në këtë edicion u prezantua nga aktori Viktor Zhusti dhe *showgirl* Ana Golja. E reja 22-vjeçare e lindur në Kanada solli në skenën e festivalit mesazhin e ruajtjes së vlerave të identitetit, si gjuha dhe kultura vendase. Ndërsa të ftuarit specialë gjatë tri netëve të festivalit në Pallatin e Kongreseve ishin Ermal Meta, Arjeta Dhima, IgliMezini, AntonioÇako dhe Erza Muçolli.

Jonida Maliqi, këngëtarja me vokalin e veçantë dhe stilin e pangatërrueshëm, ka prekur skenën e Festivalit të Këngës që në moshën 13-vjeçare në duetin me Aleksandër Rrapin, *Planeti i fëmijëve*, në vitin 1995, dhe dy vite më pas në duet me Kastriot Tushën, *Flas me engjëllin tim*. Me një pjekuri tjetër artistike,Jonida prezantohet në vitin 1999 me këngën *Do jetoj pa ty* dhe në tri vitet pasardhëse me këngët Çast, *Ik* dhe *Do humbas me ty*. Rikthimi i saj në vitin 2004 me këngën *Frikem se më pëlqen* do të renditejnë vendin e tretë. Dy vite më vonë Maliqi prezantohet me këngën *Pa identitet*, dhe në Fest' 46 me këngën *S'ka fajtor në dashuri*. Me sukses ka prezantuar edhe Festivalin e 49-të të Këngës në RTSH. Ajo u kthye në Fest '57 pas 11 vitesh.



LIBRA TË RINJ

STEFAN ÇAPALIKU "SECILI ÇMENDET SIMBAS MËNYRËS SË VET", NË KOSOVË

Në mjediset e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës është promovuar vëllimi më i ri, i treti me radhë, i romanit "Secili çmendet simbas mënyrës së vet" i autorit shkodran Stefan Çapaliku.

Sipas publicistit Agron Shala, romani "Secili çmendet simbas mënyrës së vet" i takon zhanrit letrar që në kulturën perëndimore njihet si "Bildungsroman" apo "coming-of-age", zhanër ky që merret me formimin e personalitetit të protagonistit në aspektin psikologjik e moral nga mosha e re deri në moshën e pjekurisë, shkruan RTK. Dy vëllimet e para, që kryesisht portretojnë karaktere e japin ngjarje që kanë ndodhur në Shkodër e përreth saj në kohën e regjimit të egër komunist, e që shpesh përcillen edhe me një shtresim të humorit të këndshëm, kanë gjetur lexuesin e vet, madje janë përkthyer në disa gjuhë të huaja. Çapaliku tha se nëse ky roman do të ketë një vëllim të katërt, atëherë do të merret me Facebook, pasi në vëllimin e parë është marrë me televizionin, e njerëzit po çmenden shumë lehtë. Ai shtoi se në kohën e regjimit, librat e parë i preku në Prishtinë, sepse në Shqipëri ishin të ndaluar. Të gjitha këto kujtime e bënë të shkruajë dy vëllimet e romanit "Secili çmendet sipas mënyrës së vet", dhe se është akoma më i lumtur që po e bën këtë promovim pikërisht në Prishtinë. Autori, Stefan Çapaliku, që është edhe poet, dramaturg e studiues e ligjërues i letërsisë, theksoi se ngjarjet që dëftohen në të gjitha vëllimet e romanit të tij, janë ngjarje të përjetuara nga ai vetë dhe të kaluara nëpërmjet mekanizmit krijues të tij, por nuk janë ngjarje fiksionale apo të improvizuara. Para auditorit, Çapaliku dëftoi se gjenerata e lexuesve që ka jetuar në atë kohë, e lexon romanin si dëshmi e faktografi e kohës, ndërsa gjeneratat e reja e lexojnë si krijim fiksional duke mos besuar se ngjarje të tilla do të kenë mundur të ndodhin e të jenë të vërteta. Çapaliku konfirmoi se ai do të shkruajë edhe vëllimin e katërt të këtij romani, që do të jetë edhe vëllimi i fundit. Edhe vëllimi i tretë, si dy të parët, është botuar nga Enti Botues "Gjergj Fishta" i Tiranës nën përkujdesin e Frano Kullit.

KADARE, ANËTAR I AKADEMISË SË SHKENCAVE TË MALIT TË ZI

Shkrimtari i njohur Ismail Kadare është zgjedhur anëtar i huaj i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi. Lajmi bëhet i ditur nga letra që Presidenti i Akademisë, Akademik Dragan K. Vukčević, i ka dërguar shkrimtarit. "Është nderi dhe kënaqësia ime t'ju informoj se në Asamblenë e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi, mbajtur më 18 dhjetor, 2018, Ju jeni zgjedhur anëtar i huaj i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi. Jam i sigurt se me autoritetin dhe punën Tuaj profesionale, do të kontribuoni shumë në zhvillimin e mëtejshëm dhe reputacionin e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi", shkruan presidenti i Akademisë së Shkencave të Malit të Zi, akademiku Dragan K. Vukčević.

GËZIM QËNDRO, "KINOSTUDIOJA" FJALA E FUNDIT E NJË INTELEKTUALI...

Nga Flori Slatina

Në fund të janarit të vitit 1980, një djalë i ri që vetëm pak muaj më parë kishte mbaruar Akademinë e Arteve për pikturë, emërohet në atelienë e filmit vizatimor në kinostudion "Shqipëria e Re". Ishte fat e talent që një piktor që sapo kishte mbaruar ILA-në, të emërohej në Tiranë, aq më tepër në një institucion të dorës së parë të propagandës. Piktorit të ri do t'i bënin përshtypje jo vetëm kolegët, personalitete të Artit të Shtatë, por edhe ndërtesa gjigante e kinostudios, në formë kryqi, ku hynin e dilnin jo pak, por afro 700 veta, e cila "duhet të ndihmonte Partinë në edukimin komunist të masave". Fasada e veçantë, kolonat e gjata me kapitele, medaljonet në portën kryesore, korridoret e larta dhe të kryqëzuara, muret e trasha, statujat, shatërvanët me tri guaska, kubeja e zbukuruar me piktura të kolegëve të tij më të vjetër, kryqi në mes të saj, gjithçka. Aty, në atë ndërtesë, përpunohej makijazhi, propaganda e regjimit, por për piktorin më shumë rëndësi kishte ndërtesa sesa ajo që bëhej brenda saj. Për 10 vjet do të silleshin para syve të tij ato imazhe të detajuara, të cilat i shikonte thuajse çdo ditë, për t'u fiksuar në memorie si një enigmë që kërkonte një shpjegim. Ky ishte piktori i mirënjohur, studiuesi, pedagogu dhe kritiku Gëzim Qëndro.

* * *

Personalisht, nuk kam pasur miqësi apo shoqëri me Qëndron, thjesht si gazetar e shikues e kam admiruar dhe pasqyruar punën e tij si krijues animacioni, si piktor e mbi të gjitha, nga viti 1997, si drejtor i GKA-së. E vlerësoja për intelektin, seriozitetin, qetësinë dhe përsosmërinë që i bënte gjërat. Karriera e Gëzim Qëndros kalon në disa institucione dhe kulmon si pedagog apo si studiues arti, nga më cilësorët e më skrupulozët. I formuar në Akademinë tonë të Arteve dhe më pas për katër vjet, 1992-1996, po në Akademinë e Arteve në Amsterdam, Holandë, Qëndro realizoi, si piktor e si regjisor i filmit të animuar, 5-6 filma, si: *Frymëzimi*, *Parullat*, *Pipiruku në hambar*, *Kampioni* etj., për të cilët u shpërblye edhe me çmimet e kohës, në konkurrimet zyrtare. Gjatë periudhës që drejtoi GKA-në (1997-2002), përveç afrimit të artistëve elitarë, riorganizimit të Galerisë, pavijoneve etj., konkurseve "Onufri" dhe "Marubi", veçohet për konceptimin dhe botimin e revistës "Pamorart", i vetmi organ profesionist mbi artet figurative, një revistë prestigjioze që u mungon sot artistëve. Qëndro ishte autor i dhjetëra ekspozitave, në grup e vetjake, pedagog në Akademinë e Arteve në Tiranë, akademinë "Marubi" në Prishtinë dhe në universitetin "Polis" etj., ai mbahet mend si intelektual i mirëfilltë, me një kontribut të rëndësishëm, shembull për kolegët dhe brezin e ri që patën fatin të edukohen, të punojnë e vlerësohen prej tij.

* * *

Gëzim Qëndro është autor i disa monografive për artistin dhe artistët shqiptarë: *Arkeologjia e mëngjesit*, *Heronjtë janë të uritur*, *Surrealizmi socialist* (l'Harmattan) etj. Libri i tij më i fundit ishte studimi *Kinostudioja "Shqipëria e Vjetër"*, botim i shtëpisë botuese "Onufri", 2016. Ky studim i kushtohet pikërisht kinostudios "Shqipëria e Re", ndërtesës së stërmadhe të cilën e shkeli kur ishte 22 vjeç. Nevojën për t'iu rikthyer edhe një herë kinostudios, vetë Qëndro e shpjegon si "dëshirë për t'u rikthyer përmes kujtesës në atë që dikur ishte shtëpia e tyre, [...] për t'u rikthyer në hapësirën ku lanë vitet më të bukura të rinisë e pjekurisë". Ndërtesa u inaugurua më 10 korrik 1952, si vepër e planit të parë pesëvjeçar, dhuratë e qeverisë sovjetike. Në studimin e tij, Qëndro merret pikërisht me enigmën që e shoqëron këtë ndërtesë, sidomos me faktin se përse ajo ka shumë elemente fetare, duke nisur nga ndërtesa në formë kryqi, kubeja etj., elemente që vërtetojnë plotësisht këtë fakt. Autori kërkon shpjegime se si "Kinostudioja, e ndërtuar nga një regjim që luftoi fenë me të gjitha mënyrat, madje ishte pjesë e luftës ideologjike për çrrënjosjen e fesë, mbarte tërë ato simbole e elemente kishtare", duke arritur në përfundimin se "këto simbole fetare nuk ishin pjesë e projektit të saj". I shkruar me stil, qartë dhe pastër, studimi hedh dritë mbi ato që duken e ato që nuk duken, mbi ato që thuhen e shkruhen dhe ato që mendohen e supozohen. Studimi është mbështetur në vëzhgimet e tij të holla, vetjake, për vite me radhë, deri në detaje nga më të thjeshtat e më të rëndomtat, por që marrin kuptim kur renditem e zënë vendin e duhur në libër. Mbështetet në dokumente që vijnë nga arkivi, burime të tjera, si interneti e librat, apo edhe në rrëfimet e kujtimet e njerëzve kompetentë, të cilët kanë punuar dhe drejtuar në atë institucion. Në studim gjejmë mjaft të dhëna historike, koncepte dhe





gjykime filozofike, të justifikuara nga analiza e thellë e përqasja që i bën ai fenomenit apo gjurmës, siç thotë vetë, gjejmë një analizë kritike mbi vepra të caktuara që përbëjnë e janë pjesë e veprës së madhe. Janë të rrallë ata që u ka bërë përshtypje kjo ndërtesë. Madje edhe vetë arkitektët, kur e kanë analizuar, nuk kanë shkuar më tej se një analizë e thjeshtë sipërfaqësore, apo mbi një vëzhgim të hollë, të mbështetur në atë që dukej e që, me anë të përqasjes, e kanë klasifikuar si vepër të ndërtuar në kohën e realizimit socialist. Kinostudioja ishte projektuar në Bashkimin e lavdishëm Sovjetik, që për atë kohë kur ishte gjallë diktatori Stalin, ishte gjë e madhe dhe shkonte më shumë sesa një ndihmë konkrete apo ndërtesë e thjeshtë. Ishte një vepër simbolike, një mbështetje direkte nga Stalini për diktatorin tonë (pas takimit të tyre në vitin 1949) dhe nuk është rastësi që ishte vetë ai që e përuroi me pompozitet. Qëndro përqendrohet te simbolet, të dukshme dhe të padukshme, të shfaqura dhe të fshehta, me kohën kur u realizua, me arkitektin e shquar rus Georgij Lavrov, brengat dhe ankthin e tij, me atmosferën dhe politikën ruse, dhe marrëdhëniet e saj me Kishën Ortodokse, pas Revolucionit të Tetorit, me "kryearkitektin", diktatorin Stalin, pa firmën e të cilit nuk kalonte asgjë, me aktorët protagonistët shqiptarë, aq të shumtë në numër, nga punëtorët e thjeshtë, te personalitetet e artit shqiptar, të cilët lanë gjurmën e tyre sipas vulës së sistemit politik.

Kur lexon librin, shikon një lëndë aq të pasur që dëshmon për kulturën e gjerë e të thellë të autorit, shikon përfundime e analiza të sakta e shteruese (në fakt, vetë Qëndro thotë, në fund të studimit të tij, se "ky libër studimor merr përsipër vetëm të paraqesë fakte të pashpjegueshme dhe kundërthënëse, pa mëtuar kurrsesi të japë shpjegime shteruese") që nuk lënë shteg për interpretime të tjera, por nuk besoj se tani për tani, ose në një të ardhme të afërt, ndonjë studiues tjetër do të thotë diçka më shumë e më mirë se ky autor. Sot, për fat të keq, "nga magjia e dikurshme, e ngjashme me kalimin nëpër makinën e kohës, nuk ka mbetur pothuajse asgjë". Ai dinozaur i vjetër i propagandës, që me të drejtë Qëndro e quan "një aristokrate të rënë nga fakti" dhe e emërton *Kinostudioja "Shqipëria e Vjetër"*, sot, edhe pse është restauruar e tjetërsuar, ajo e ka humbur funksionin dhe magjinë e dikurshme dhe për shumë veta, do të jetë një kujtim i largët, dhe më shumë se kujtdo do t'u hyjë në punë historianëve të kinemasë apo të arkitekturës.

Ky shkrim i shkurtër mbi "fjalën e tij të fundit", kjo vepër studimore me vlera jo vetëm për arkitekturën, por edhe për kritikën, për artet në përgjithësi, vjen si homazh për një nga figurat e shquara të kritikës, pedagogjisë, intelektualin e mirëfilltë Gëzim Qëndro, që në dhjetor do të mbushte 62 vjet nga lindja e tij, por që fatkeqësisht u nda nga jeta para kohe, më 27 shkurt 2018, kur ende kishte shumë për t'i dhënë shkencës, kritikës, artit.

LIBRA TË RINJ

DONAL RYAN
"E VEÇANTA E DHJETORIT" NË SHQIP

Romani i Donal Ryan i përkthyer nga Renato Kalemi Zhanri sjell një histori, sa të ëmbël, aq dhe të hidhur, që na kujton se në jetë jemi të rrethuar nga shpirtra të thjeshtë, të cilët shpesh janë më të thellë e më të mençur se ç'mund të mendojmë. Romani "E veçanta e dhjetorit" rrëfen një vit nga jeta e Xhonsi Kanlajfit, një djalosh i vetmuar, pa përvojë, pa miqësi apo ambicie, që jeton në po atë zonë rurale të Irlandës ku ndodhin ngjarjet e romanit "Zemra vërtitëse", shkruar nga i njëjti autor. Megjithëse i botuar pas këtij të fundit, ngjarjet e paraqitura në romanin "E veçanta e dhjetorit" janë më të hershme: ato zhvillohen para krizës financiare të vitit 2008, që përfshiu jo vetëm Irlandën, por gjithë Europën. Romani është i ndarë në 12 kapituj, ku në secilin prej tyre përshkruhet një muaj nga një vit jetë e Xhonsit. Teksa ekonomia e vendit është në vlim dhe makutëria kthehet në normalitet, Xhonsi përpiqet dëshpërimisht të ruajë atë çka i është familjare, e njohur dhe e ngrohtë, megjithëse ndërkohë ka humbur të gjithë ata që e kanë mbrojtur nga egërsia e jetës. Pas vdekjes së prindërve, Xhonsi trashëgon fermën e familjes dhe një llogari bankare të majme, megjithëse është i paaftë për t'u kujdesur për to. "Gangot" e fshatit dhe mashtrues të ndryshëm e përndjekin, e megjithëse copëza dashurie hyjnë në jetën e tij në vendin dhe kohën më të çuditshme, Xhonsi mbetet njeri i vetmuar, i cili ka vështirësi t'i rrijë pas botës që lëviz me ritme marramendëse. Në rrëfim gjurmohen me zgjuarsi shkaqet fillestare të rritjes së pakontrolluar të çmimeve të pronave të patundshme, të vuajtjes së shumë të pafajshmëve, si dhe shfaqet shkatërrimi i komuniteteve, që dikur jetonin në harmoni.

Kritika shkruan se libri i shpie lexuesit në mendjen e një njeriu që ka vështirësi të çajë në një botë, të cilën nuk arrin kurrë ta kuptojë plotësisht. Nëse romani i parë i Donal Ryan "Zemra vërtitëse" ishte kandidat për Man Booker Prize dhe fitoi çmimin "Libri i vitit, 2012" në Irish Book Aëards, çka shihet si një fillim jo i keq për karrierën letrare, e vetmja anë negative ishte se ai përveshi mëngët për sfidën e romanit të dytë. "Fakti që ai ia doli mbanë, dhe me shumë zhdërvjelltësi madje, dëshmon se kemi të bëjmë me një prej shkrimtarëve të rinj më të talentuar bashkëkohorë", shkruante "The Independent". Autori Donal Ryan (1976) është një ndër shkrimtarët irlandezë bashkëkohorë më premtues. Ai ka lindur në Nenagh, në Kontenë Tipperary, në Irlandë. Ka qenë nëpunës i sektorit publik për shumë vjet. Dhe vetëm më 2014, pas suksesit që korri "Zemra vërtitëse", romani që e shkroi gjatë mbrëmjeve të verës së 2010-ës, i është kushtuar tërësisht krijimtarisë letrare. Romani i tij i parë u refuzua nga 47 botues, derisa më në fund arriti të gjente një të tillë. Dy romanet e tij të para "Zemra vërtitëse" dhe "E veçanta e dhjetorit" kanë arritur majat e kritikës irlandeze dhe europiane. "Zemra vërtitëse" ka fituar The Guardian First Book Award, Çmimin Europian për Letërsinë (2015), titullin "Libri i Vitit" në Çmimet e Librit Irlandez. Donal Ryan është diplomuar në Universitetin e Limerick-ut.

GJENDET NJË DORËSHKRIM I HUMBUR I NOBELISTIT NAGUIB MAHFOUZ

PËRMBLEDHJA ME TREGIME ISHTE E FSHEHUR NË NJË KUTI

Nga Marcia Lynx Qualey

Naguib Mahfouz është fytyra e njohur e letërsisë egjiptiane. Nëse egjiptianët nuk i kanë lexuar romanet e shumta të laureatit të Çmimit Nobel, me siguri kanë parë ndonjë nga filmat e tij. Për më tepër, ai ishte gjithmonë i afrueshëm me shkrimtarët e rinj dhe admiruesit, gjatë mbledhjeve shoqërore të përjavshme. E megjithatë, pas kësaj gatishmërie të ngrohtë, gjendej një burrë tejet i kujdesshëm që griste bocat, letrat dhe dorëshkrimet e tij.



Disa vite më parë, kritiku i mirënjohur egjiptian, Mohamed Shoair, i caktoi vetes detyrë të kërkonte dorëshkrimin e romanit më famëkeq të Mahfouz, *Fëmijët e rrugicës*. Libri në fillim u publikua rregullisht në gazetën *Al Ahram* në vitin 1959, ku u kundërshtua fort nga një radhë politikanësh dhe figurash fetare. Pasi ankesat vërshuan drejt presidentit Gamal Abdel Nasser, kjo shëmbëlltyrë e shkëlqyer, u bë romani i vetëm i Mahfouz që u ndalua në Egjipt. Ky ishte gjithashtu romani i cili nxiti atentatin që iu bë më vonë.

Shoair, i cili ishte pjesë e një brezi të re të kritikëve egjiptianë, ishte i vendosur për të gjetur dorëshkrimin origjinal. Ai foli me Philip Stewart, përkthyesin e parë të romanit në gjuhën angleze, i cili me shaka tha, "ndoshta gjendet në një kasafortë banke në Beirut!"

Stewart i tha Shoair se ndërsa po përkthente librin nga kopjet e gazetës, ai kishte kërkuar dorëshkrimin origjinal. Por Mahfouz nuk e kishte. Ai i kishte thënë se dorëshkrimin ia pati dhënë gazetës *Al Ahram*, dhe nuk ia kishin kthyer. Gati një dekadë më vonë, romani u gjend në Beirut, dhe Stewart supozoi se dikush te *Al Ahram* duhet ta ketë shitur dorëshkrimin. Megjithatë, botuesi nga Libani, Dar al-Adab, i tha Shoair se as ata nuk e kishin. E as arkivistët te gazeta Al Ahram.

Kur Shoair pyeti vajzën e vetme të gjallë të Mahfouz se ku mund të gjendej dorëshkrimi, ajo tha se familja nuk zotëronte ndonjë gjë përveç atyre që diheshin nga të gjithë. Por ndërsa ai vazhdonte ta pyeste, ajo kujtoi një kuti me fletë të vjetra të cilën e kishte mbajtur mamaja e saj. E kështu, caktuan një datë që Shoair të vinte ta kontrollonte.

Kjo kuti magjike ishte një pikë kthese në kërkimin e Shoair. Edhe pse nuk e gjeti dot atë që kërkonte, dorëshkrimin e librit *Fëmijët e rrugicës*, ai zbuloi plot boca të tjera. Ai tha se Mahfouz shkruante me laps, në letra me format të madh, dhe ato që shkruante i fshinte shpesh. Më pas Shoair hasi diçka tjetër: një dosje të trashë me një shënim të shkarravitur mbi të, i cili të linte të kuptoje se tregimet brenda ishin lënë për t'u botuar në vitin 1994.

Ndërsa shfletonte rreth 50 tekste të shkurtra, Shoair kuptoi se disa prej tyre nuk i kishte lexuar ndonjëherë. Për tre ditë, ai kërkoi për këto tregime në veprat e botuara të Mahfouz, dhe zbuloi se shumica prej tyre, ishin publikuar në revistën *Nisf al-Dunia*. Megjithatë, 18 nga këto tregime të shkurtra nuk ishin botuar asnjëherë. "Nuk mendoj se Mahfouz i la qëllimisht të pabotuara këto vepra", tha ai. "Dhe vlera e tyre artistike është e fortë".

Shoair mendon se Mahfouz e humbi rrjedhën e tregimeve për shkak të asaj që ndodhi në 14 tetor të vitit 1994. Mahfouz hipi në makinë me një mikun e tij, kur një djalosh u afrua. Mahfouz, duke menduar se ishte një admirues, uli xhamin. Njëzetetrevjeçari me emrin Mohammed Nagui, i cili ishte riparues pajisjesh dhe një terrorist, u zgjat brenda dhe e goditi me thikë në fyt shkrimtarin e madh. Për mrekulli Mahfouz shpëtoi, por një nerv në qafën e tij u dëmtua në mënyrë të përhershme. Pas një shërimi të gjatë, Mahfouz nuk mund të mbante dot një stilolaps për më shumë se një ose dy minuta. Megjithatë, ai nuk ndaloi së krijuari dhe u detyrua t'i thoshte me zë veprat e shkurtra të fundit.

Mahfouz vdiq 12 vite më vonë, në 2006, kur ishte 94 vjeç.

Shoair thotë se tregimet në këtë përmbledhje të re – të titulluar *Pëshpërima e yjeve* – kujtojnë atmosferën e romanit të shkëlqyer të vitit 1977, *The Harafish*. Versioni arabisht u botua në 11 dhjetor: 107 vjetori i lindjes së Mahfouz. Çuditërisht, dhe me zhgënjimin e disa egjiptianëve, në Beirut do të botohet nga Dar al-Saqi. Shtëpia botuese motër e al-Saqi në Londër, vjeshtën e ardhshme do të botojë përkthimin e Roger Allen. Roger Allen, përkthyes dhe pedagog i dalë në pension, pati një marrëdhënie të gjatë me Mahfouz. Përkthimi i parë i botuar i Allen ishte përmbledhja me tregime të shkurtra e Mahfouz me titullin *Bota e Zotit* (1973), e cila u përkthye bashkë me Akef Abadir.

Në një shtëpi-varkë pranë vendbanimit të Mahfouz. "Në atë kohë", shpjegon Allen, "Mahfouz ishte gati i verbër dhe jo pak i shurdhët, prandaj personi në të majtën e tij është ai çfarë ne e quanim "bërtitësi", i cili, çdo disa minuta, i tregonte Mahfouz se për çfarë kishim biseduar. Sigurisht, të gjithë do të prisnim përgjigjen e tij e cila, shpesh ishte e mprehtë".

Në fund të tetorit, Lynn Gaspard nga shtëpia botuese Saqi Books, ia dërgoi tekstet Allen-it që t'i bënte një përmbledhje. Pasi ma tha këtë në telefon nga shtëpia e tij në Philadelphia, Allen qeshi me të madhe. Ai tha se i lexoi shpejt këto tregime përpara se t'i thoshte Saqi-t, "me siguri po tallesh – sigurisht që ia vlen ta bësh!"

"Lashë gjithçka dhe nisa të merresha me to", tha Allen. "U mahnita tej mase".

Allen fliste me një entuziazëm të dukshëm, pasi kishte përfunduar një draft të parë të përkthimit. Agjentja Yasmina Jraissati, e cila përfaqëson këtë vepër, e quan *Pëshpërima e yjeve* një përmbledhje tregimesh që lidhen me njëri-tjetrin, secili prej tyre me një ndërlikim dhe "një përfundim që të tregon shumë mbi personazhet".

Por Allen nuk donte t'i quante ato tregime të shkurtra.

"Janë rrëfime të shkurtra", thotë Allen. "Ajo që më duket interesante ... është se zhvillohen në të njëjtin vend, për të cilin përdor fjalën e veçantë *hara*, ose lagje. I njëjti ambient, të njëjtët personazhe, shfaqen te pothuajse të gjithë tregimet. Kemi kryetarin e lagjes. Imamin e xhamisë. Kafenenë aty pranë. Dhe mbi të gjitha, në cepin e lagjes, gjendet një fortesë e vjetër. Cilido që shkon te kjo fortesë kthehet disi i transformuar. Ashtu si shumë vepra të tij të fundit, sjell një nocion të fortë të dallimeve të sektit Sufi ndërmjet asaj që shihet dhe asaj që nuk shihet, asaj që dihet dhe asaj që nuk dihet".

Për Shoair, puna e detektivit vazhdon. Në shtator, ai botoi pjesën e parë të trilogjisë së tij mbi Mahfouz: *Fëmijët e rrugicës: Historia pas një romani të ndaluar*. Pjesa e dytë është në punim, me titull *Dorëshkrimet e Naguib Mahfouz*.

Shoair shtoi përmes një mesazhi enigmatik në Twitter se "surprizat nuk mbarojnë këtu". Ai tha se shpejt do të ketë njoftim për një zbulim "i cili është ndoshta më i rëndësishëm se tregimet". Kur u pyet mbi natyrën e këtij njoftimi, Shoair u përgjigj me dy fytyra të buzëqeshura.



Mundal, Norway

DY QYTETE, NË NORVEGJI DHE BRITANINË E MADHE, KU KA MË SHUMË LIBRA SE BANORË

Hay-on-Wye, Wales